

Abdurr-rahman Nasir Es-Saëdijj

PEMA E BESIMIT



شجرة الإيمان (باللغة الألبانية)



Conveying Islamic Message Society

P.o.Box 834 - Alex - Egypt

E-Mail: info_en@islamic-message.net

E-Mail: cims_eg@yahoo.com

Site: www.islamic-message.net

Not for sale نهري ولا يباع

Abdurr-rahman Nasir Es-Saëdijj



PEMA E BESIMIT'

*Kuptimi i besimit (imanit),
themelet dhe burimet e tij,
me s'ka ushqehet,
dobitë dhe frytet e tij.*

Abdurr-rahman Nasir Es-Saëdijj

Titulli në origjinal:

(Et-Teudih vel-bejan li shexharatil-imaan)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit

Lavdia dhe përnderimet i takojnë Allahut, Atë e lavdërojmë dhe nga Ai ndihmë e falje kërkojmë. Lusim Allahun të na ruajë nga të këqijat e shpirtrave tanë dhe të punëve tona. Kë e udhëzon Allahu, nuk ka kush që e lajthit nga Rruga e drejtë, e atë të cilin Ai e humb, askush nuk mund ta udhëzojë në Rrugë të drejtë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar përveç Allahut Një dhe të pashoq, dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguari i Tij.

Meqenëse ngritja e ndërtesës varet nga forcimi i themelit dhe i bazës së saj, atëherë për atë që do të ngrejë një ndërtesë të lartë është e nevojshme ta forcojë themelin dhe bazën e saj. Allahu ka thënë në Librin e Tij, Kur'an:

“A është më i mirë ai i cili vuri themelin e ndërtesës së tij tek përkushtimi ndaj Allahut dhe kënaqësisë së tij, apo ai i cili vuri themelin e ndërtesës së tij të paqëndrueshme buzë greminës, saqë u thërrmua bashkë me të në zjarrin e xhehennemit? Allahu nuk i udhëzon zullumqarët (politeistët, keqbërësit).” (Et Teube, 109)

Themel i çdo pune në islam është besimi (imani) i drejtë mbi të cilin qëndron ajo punë, ashtu siç qëndron ndërtesa mbi shtyllat e saj.

Është thënë:

*Shtëpia nuk ngrihet veçse me shtylla
Dhe as shtyllat nuk qëndrojnë
pa u ngulitur thellë në tokë*

Muslimani ka nevojë të forcojë besimin (imanin) e tij vazhdimisht, sidomos në kohën kur jetojmë, kur dukuria e besimit (imanit) të dobët është përhapur shumë.

Të vërtetën e ka thënë një poet:

*Kur të humbë besimi
Nuk mbetet amaneti e as dynjaja
Për atë që nuk e ngjall fenë e tij*

Së këndejmi, ajo që është më e rëndësishmja ta mësojë muslimani dhe t'ua mësojë të tjerëve janë çështjet e besimit: shtyllat, kushtet, detyrimet ndaj tij, gjërat që e forcojnë dhe e ushqejnë atë, në çka mbështetet etj. Pastaj ai duhet të përpiqet ta jetësojë atë besim (iman) me dije e me punë, në mënyrë që ta forcojë besimin e tij dhe ta bëjë sa malet e larta,

Dijetari i madh Abdurr-rahman Ibën Nasir Es-Saëdlj na merr me fjalët e tij të mira për të na njohur me këtë pemë, pemën e imanit, që është pema më e mirë, me tiparet dhe me frytet e saj të dobishme.

PARATHËNIA E AUTORIT

Falënderimi i takon Allahut, i Cili e mbolli pemën e imanit në zemrat e robërve të Tij të zgjedhur, e ujiti atë dhe e ushqeu me dituri të dobishme e me njohuri të vërteta, me kujtim të vazhdueshëm të Tij - ditën dhe natën - e pastaj bëri që ajo ta japë frytin e saj të mirë dhe të begatshëm. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar përpos Allahut,¹ të Vetmit, i Cili nuk ka partner, të Gjithëfuqishmit, Bujarit, Mëshiruesit, Falësit, dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij. O Zot! Mëshiroje dhe dërgo paqe mbi Muhammedin, familjen, ndjekësit dhe mbi shokët e tij të mirë e të zgjedhur!

Ky libër shtjellon imanin,² që është një ndër themelet më të rëndësishme dhe më të mëdha të së Vërtetës. Këto themele mbështeten në Librin e Zotit, që garanton ngritjen e këtyre themeleve pa pasur nevojë për diç tjetër. Mbështeten gjithashtu në sunnetin³ e Muhammedit, paqja qoftë mbi të, i cili përputhet me Librin e Allahut dhe është sqarues i tij, duke i shpjeguar shumë gjëra në imtësi, për te cilat Kur’ani flet vetëm në formë të përgjithshme.

Libri fillon me sqarimin e kuptimit të imanit, e pastaj tregon në çka bazohet, mbi çka ngrihet dhe me çka ushqehet, e më në fund përmënd dobitë dhe frytet e tij, si dhe atë çka lidhet me këto tema. Zoti thotë në Kur’an:

¹ Kjo është dëshmia La ilahe il-Allah.

² Imani ose në kuptimin e ngushtë besimi, ndërsa Kur’ani i jep kuptim më të gjërë: besim, deklaram i këtij besimi me gjuhë dhe veprim me gjymtyrë sipas këtij besimi. Në pjesën e parë të librit sqarohet kjo.

³ Fjalët, punët, porositë e Muhammedit alejhis-selam.

“A nuk e sheh se si Allahu sjell shembull një fjalë të mirë si një pemë të mirë, rrënjët e së cilës janë të ngulitura (në tokë) e degët e saj ngrihen lart në qiell. Me vullnetin e Zotit të saj ajo jep frutin e vet në çdo kohë. Allahu njerëzve u jep shembujt krahasues, ashtu që ata të përkujtojnë.” (Ibrahim, 24-25)

Allahu, pra, e ka krahasuar fjalën e imanit, që është fjala më e mirë, me një pemë më të mirë, të cilësuar me shumë veti të çmuara, si: rrënjët i ka të ngulitura thellë në tokë, ajo vazhdimisht rritet e zhvillohet, e frutat e saj në çdo kohë i sigurojnë pronarit të saj edhe të tjerëve dobi të llojllojshme. Kjo pemë nuk është e njëjtë në të gjitha zemrat e besimtarëve, mirëpo ndryshon varësisht se sa gjenden në të cilësitë të përmendura më lart në Kur’an.

Prandaj, njeriu ka për detyrë ta njohë atë pemë, t’i njohë cilësitë e saj, ta njohë arsyen e rëndësisë së saj, rrënjët dhe degët e saj, dhe ta mbjellë atë pemë në zemrën e tij, ngase e mira, shpëtimi dhe lumturia e tij në këtë botë dhe në të ardhmen varet nga ajo se sa e ka realizuar ai këtë pemë në zemrën e tij.

KAPITULLI I PARË

PËRKUFIZIMI I IMANIT (BESIMIT) DHE KUPTIMI I TIJ

Përkufizimi i gjërave dhe interpretimi i tyre, që i sqaron ato, i paraprijnë gjykimit për ato gjëra, ngase gjykimi për gjërat rrjedh nga kuptimi që kemi për të njëjtat (gjëra). E kush gjykon për një çështje para se ta njohë dhe ta kuptojë mirë atë ka bërë gabim serioz.

Prandaj, ta dimë përkufizimin dhe kuptimin e imanit: Me shprehjen *iman* kuptojmë besim të paluhatshëm dhe pranim të të gjitha atyre gjërave në të cilat Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë urdhëruar të besojmë, si dhe nënshtrim ligjit të Allahut në aspektet e tij dukshme dhe në të fshehurat.

Pra ai është vërtetim dhe besim i zemrës, që përmban veprat e zemrës dhe veprat e trupit, e kjo në të vërtetë përfshin kryerjen e të gjitha veprave fetare. Për këtë arsye, imamët dhe selefi⁴ e kanë përkufizuar imanin si: fjalë e zemrës dhe gjuhës, dhe vepër e zemrës, e gjuhës dhe e gjymtyrëve. Ai është fjalë, vepër dhe besim, shtohet me nënshtrim (Zotit të Dërguarit të Tij) dhe pakësohet me mëkatim ndaj tyre.

Duke u nisur nga kjo, imani përmban besimin, moralin dhe veprat. Prandaj besimi dhe pranimi i emrave të bukur të Allahut dhe i cilësive të përsosura dhe të larta të Tij, si dhe punët që burojnë si rezultat i frymëzimit nga këta emra dhe cilësi të Tij, janë nga themelet më të rëndësishme të imanit.

⁴ Imamët: prijësit fetarë, dijetarët, Selefi: gjeneratat e hershme muslimane, dallohen për nga kuptimi i drejtë i Islamit dhe për praktikim të përpiktë të tij.

Po ashtu, kryerja e detyrimeve që i kemi, veçanërisht ndaj Zotit, që është adhurimi i Zotit në formë të dukshme dhe të fshehur, është themel i imanit. Edhe pranimi i asaj me çfarë Allahu na ka lajmëruar për melaqet e Tij dhe për ushtrinë e Tij, për krijesat e kaluara dhe të ardhmet, si dhe për Ditën e Fundit, është themel i imanit.

Besimi në të gjithë të dërguarit dhe në ato virtyte me të cilat janë cilësuar ata në Librin e Zotit dhe në Sunnet është themel i imanit. Po ashtu, themel shumë i rëndësishëm i imanit është pranimi i Allahut si hyjni e vetme, veçimi i Allahut me adhurim, si dhe kryerja e detyrimeve islame, qofshin ato të dukshmet a të fshehtat.

Të gjitha këto që u përmendën ndërtojnë themelin e imanit. Mu për këtë shkak, Allahu ka bërë rrjedhojë të imanit hyrjen në xhennet dhe shpëtimin nga xhehennemi. Rezultate të imanit janë kënaqësia e Zotit, shpëtimi dhe lumturia. Kurse këto nuk arrihen ndryshe veçse nëse imani përmban ato që i përmendëm më sipër: besimin, veprat e zemrës⁵ dhe veprat e gjymtyrëve, ngase mungesa e njërës nga këto tri elemente shkakton mangësi në iman, njeriu nuk shpërblehet për të dhe ai bëhet shkak i dënimit - varësisht nga ajo se sa është i mangët imani. Allahu i Madhërishtëm na ka treguar se gradat më të larta në këtë botë dhe në botën tjetër arrihen me iman. Allahu thotë:

“E ata që besuan në Allahun dhe në të dërguarit e Tij janë të singëritit (siddikun).” (El Hadid 19)

⁵ Veprat e zemrës janë: nijjeti (qëllimi), singëriteti, dashuria, frika e të ngjashme.

E “të sinqertit” janë njerëz që më së tepërmi i ka ngritur Kur’ani, pas pejgamberëve, në këtë botë dhe në botën e ardhshme. Allahu na tregoi se kush beson në Të dhe në të dërguarit e Tij e arrin këtë shkallë. Për këtë kategori njerëzish flet hadithi në përmbledhjen e Buhariut dhe Muslimit, ku Pejgamberi paqja e Allahut qoftë mbi të, thotë:

“Vërtet banorët e xhennetit do t’i shohin banorët e dhomave të xhennetit, sikurse e shihni yllin lindor a perëndimor në horizont, për shkak të gradimit të ndryshëm mes tyre”. Njerëzit thanë: “O i Dërguar i Allahut! A janë ato gradat e pejgamberëve, të cilat nuk i arrin askush pos tyre?” Tha: “Assesi, pasha Atë në dorë të të Cilit është shpirti im, ata janë burra që kanë besuar Allahun dhe të dërguarit.”

Ky besim në Allahun dhe në të dërguarit e Tij pasqyrohet në brendësinë e tyre dhe në të jashtmen e tyre, në besimin, moralin dhe punët e tyre, dhe në nënshtrimin e plotë Allahut dhe të dërguarit të Tij. Pra, nëse ata i kryejnë këto, atëherë ata e kanë realizuar besimin (*imanin*) e tyre në Allahun dhe në të dërguarit.

Allahu në Librin e Tij na ka urdhëruar me këtë besim të përgjithshëm dhe me dorëzim e pasim, dhe e ka lavdëruar atë që e bën këtë. Në ajetin më të madh të imanit ka thënë:

“Thoni: Ne besojmë Allahun dhe atë që na është dërguar neve dhe atë që i është zbritur Ibrahimit, Ismailit, Is-hakut, Jakubit e bijve të tij, atë që i është dhënë Musait, Isait dhe në çfarë u është dhënë të gjithë pejgamberëve nga Zoti i tyre. Nuk bëjmë dallim mes tyre dhe ne Atij i dorëzohemi.” (El Bekare 136)

Allahu, pra, i ka urdhëruar robërit e tij të besojnë në të gjitha këto themele të mëdha, të besojnë në të gjitha librat që i ka zbritur Ai dhe në të gjithë profetët që i ka dërguar Ai, i ka urdhëruar të jenë të sinqertë e t'i dorëzohen vetëm Atij, siç thuhet në fund të ajetit: “Dhe ne Atij i dorëzohemi”. Në fund të kaptinës El Mu’minun Allahu i ka lavdëruar besimtarët që e realizojnë besimin:

“I Dërguari beson në atë që i është zbritur atij nga Zoti i tij dhe po kështu edhe besimtarët (besojnë). Secili prej tyre beson në Allahun, në melaqet e Tij, në Librat e Tij dhe në të Dërguarit e Tij. (Ata thanë): Ne nuk bëjmë dallim mes të dërguarve të Tij dhe thanë: Dëgjuam dhe respekтуam. Na fal o Zoti ynë, kthimi është tek Ti!” (El Bekarah, 285)

Në këtë ajet Allahu tregon se i Dërguari Muhammed dhe besimtarët që janë me të kanë besuar në këto themele pa bërë dallim ndërmjet peygamberëve, dhe u kanë besuar të gjithë atyre dhe asaj çfarë atyre u është dhënë nga Allahu. Ata gjithashtu i janë nënshtruar Allahut dhe kanë thënë: **“Dëgjuam dhe respekтуam”**, pastaj kanë kërkuar nga Zoti i tyre t’u ndihmojë dhe t’ua falë atyre ndonjë mangësi në iman. E kthimi i të gjitha krijesave dhe drejtimi i tyre është nga Allahu, Ai i shpërblen për imanin e tyre të plotë dhe i dënon për mangësitë në iman. Zoti i Lartë tregon se pasuesit e peygamberëve - të Isait e të tjerëve - kanë thënë:

“Zoti ynë, ne besojmë atë që Ti e zbritte dhe e pasuam të Dërguarin. Na shkruaj pra prej dëshmuesve (të së Vërtetës - La ilahe il-lallah, nuk ka të adhuruar tjetër të merituar përveç Allahut).” (Ali Imran, 53)

Ata besuan me zemrat e tyre dhe u nënshtruan me zemrat dhe gjymtyrët e tyre, pastaj kërkuan nga Allahu t'i shënojë bashkë me ata që e dëshmojnë njëjësinë e Allahut (teuhidin) dhe t'u ndihmojë ta realizojnë imanin me fjalë, me vepra dhe me besim. Allahu i Gjithëpushtetshëm thotë:

“Besimtarë janë vetëm ata të cilët kur të përmendet Allahu, u dridhen zemrat e tyre dhe kur u lexohen vargjet e Tij (Kur’ani) ato ua shtojnë edhe më besimin (imanin) dhe ata i mbështeten vetëm Zotit të tyre. Të cilët me përpikëri e falin namazin dhe që shpenzojnë nga ato gjëra me të cilat Ne i kemi furnizuar. Mu këta janë besimtarët e vërtetë. Për këta do të ketë nderim të lartë te Zoti i tyre, falje dhe begati të nderuar.” (El Enfal, 2-4)

Allahu i cilëson besimtarët me këto tipare, të cilat në vete përmbajnë themelet e fesë dhe degët e dukshme dhe të fshehta të saj. Ai i ka cilësuar si besimtarë ata besimi i të cilëve lë gjurmë në zemrat, në fjalët dhe në punët e tyre të dukshme dhe në të fshehtat. E kur besimi të zëre vend në zemrat e tyre, ai shtohet sa herë që u lexohen atyre ajetet e Allahut (Kur’ani), atyre u shtohet frika dhe u ngjethet zemra sa herë që të përmendet Allahu. Ata me zemrat e tyre i janë mbështetur Allahut dhe të gjitha çështjet e tyre ia kanë besuar Atij, pastaj ata e falin namazin e detyruar dhe vullnetar, e falin atë me gjymtyrë të jashtme dhe me zemër, e japin zeqatin dhe japin lëmoshë.

E kush cilësohet me këto cilësi ai vrapon pas çdo të mire dhe ikën nga çdo e keqe, dhe mu për këtë Allahu thotë: *“Mu këta janë besimtarët e vërtetë.”* Pra, ata me të vërtetë e meritojnë këtë emër dhe e vërtetojnë imanin haptazi dhe

fshehtazi. Pastaj, Allahu e përmendi shpërblimin e madh për ta: falje, nderim te Zoti, furnizim të madh dhe dhunti që syri nuk ka parë, veshi nuk ka dëgjuar dhe mendja e njeriut nuk i ka përfytyruar dot. Allahu i Madhërisëm thotë:

“Vërtet, që tashme kanë fituar besimtarët. Ata të cilët në namazin e tyre janë të përlur. Edhe ata të cilët i shmangen së kotës (fjalë a punë, rrenës, mashtrimit, përgojimit etj). Edhe ata të cilët e japin zekatin. Edhe ata të cilët i ruajnë pjesët e tyre vetjake, përveç ndaj grave të veta dhe ndaj atyre që i kanë në pronësinë e vet (robëreshat), për të cilat nuk qortohen. Po kush kërkon përtej kësaj, të tillët janë ata që i kanë shkelur normat e caktuara. Edhe ata të cilët janë besnikë ndaj amanetit⁶ të tyre dhe besës së dhënë. Edhe ata të cilët i kushtojnë kujdes faljes së namazit të tyre. Këta janë me të vërtetë trashëguesit, të cilët do të trashëgojnë Firdevsin (Xhennetin më të lartë). Ata aty do të jenë përgjithmonë.” (El Mu’minun, 1-11)

Në këto ajete Allahu na bën me dije se të gjitha këto virtyte të përmendura janë pjesë të imanit të besimtarëve. Ai na tregoi se besimtarët janë të shpëtuar, pastaj i cilësoi si njerëz që janë të përlur në namazin e tyre etj. Prandaj, kush i ka këto cilësi ai është besimtar i vërtetë. Të gjitha këto cilësi, thënë shkurt, janë kryerja e detyrimeve të dukshme dhe të fshehta dhe largimi nga ndalesat dhe gjërat e urryera. Me këtë iman të plotë ata i meritojnë xhennetet e Firdevsit, të cilat janë xhennetet më të larta. Ky është argument i qartë se imani përfshin: besimet fetare, moralin fetar dhe veprat fetare të dukshme e të fshehtat.

⁶ Amanetet: Detyrimet ndaj Allahut ndershmëria, besimi, përgjegjësia morale.

Duke u nisur nga kjo, imani shtohet me shtimin dhe me realizimin e këtyre cilësive, kurse pakësohet me pakësimin e të njëjtave. Dhe njerëzit kanë iman të ndryshëm, dikush me të plotë e dikush më të mangët, varësisht nga dallimi në ato cilësi tek secili njeri. Prandaj, besimtarët janë tri kategorish:

1. Të parët në punë të mira, të afërmit (el-mukarrebun). Ata janë të cilët i zbatojnë detyrimet (vaxhibet) dhe punët e pëlqyera (mustehabet) dhe largohen nga të ndaluarat (haramet), nga punët e urryera (mekruhët) dhe nga teprimi në punë të lejuara,

2. Mesatarët. Ata janë të cilët i kryejnë detyrimet dhe largohen nga të ndaluarat,

3. Ata që i bëjnë dëm vetvetes. Ata janë të cilët i kanë lënë disa detyrime të imanit dhe i kanë bërë disa hareme. Kjo ndarje mbështetet në Kur'an:

“Pastaj Ne u dhamë për trashëgim Librin (Kur’anin) të atillëve nga robërit Tanë të cilët Ne i zgjodhëm (pasuesit e Muhammedit). Pastaj prej tyre janë disa që i bëjnë dëm vetvetes së tyre, dhe po prej tyre janë disa të cilët ndjekin një rrugë të mesme, dhe po prej tyre disa që janë më të parët në punë të mira me vullnetin e Allahut. Ai (trashëgimi i Kur’anit), mu ai është me të vërtetë mirësi e madhe.”(Fatir, 32)

Shpeshherë Allahu ia bashkon imanit punët e mira, ose takvallëkun (devocionin)⁷, durimin, që të mos mendojë dikush se imani mjafton vetëm me zemër.

⁷ TakuAllahi do të thotë ruajtje nga hidhërimi i Allahut përmes kryerjes së detyrimeve (vaxhibeve) dhe ikjes nga të ndaluarat (haremeve).

Shumë herë në Kur'an thuhet: *"Ata që besuan dhe bënë vepra të mira..."*,⁸e pastaj përmenden cilësitë e tyre. Punët e mira janë pjesë të imanit dhe nga domosdoshmëritë e imanit, me ato vërtetohet dhe realizohet imani. Prandaj, kush mëton se është besimtar dhe në të njëjtën kohë nuk punon me atë që Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë urdhëruar dhe nuk largohet prej asaj që Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë ndaluar, i tilli nuk është i sigurtë në imanin e tij. Shumë herë në Kur'an imanit i bashkohet takvallëku, p.sh.:

"Nuk ka fare dyshim! Me të vërtetë, për eulijatë e Allahut (të përkushtuarit, besimtarët e vërtetë që i dorëzohen plotësisht Allahut) as frikë nuk do të ketë për ta, e as nuk do të pikëllohen. Të cilët besuan (në njëjësinë e Allahut, në Islam) dhe që gjithnjë e patën frikë Allahun (me përkushtim ndaj Tij duke u ndalur prej së keqes e duke vepruar të mirën)." (Junus, 62, 63)

Ka përmendur imanin, që e përfshin atë që është në zemra: besimin, qëllimet e mira dhe punët e mira. E kjo siguri nga frika dhe brengosja nuk i mundësohet besimtarit përderisa të ruhet nga hidhërimi i Allahut, qoftë ai hidhërim i shkaktuar nga mosbesimi (kufri), qoftë nga mëkati i tij. Kjo ruajtje realizohet me fjalën e Allahut: ". . . dhe ruheshin nga hidhërimi i Allahut."⁹

⁸ Shih: El Bekarah, 25. 82. 277, Ali Imran, 57, En-Nisa 34, 122, 124, 173, El-Maide 93. El-A'raf 42. El-Buruxh 11, Et-Tin 6, El-Bejjine 7, El-Asr 3 etj.

⁹ Allahu e meshiroftë tabi'iu e njohur Talk ibn Habib, i cili kur është pyetur për takvallëkun ka thënë: "Të punosh me respekt ndaj Allahut, me dritë nga Allahu, të shpresosh shpërblimin e Allahut dhe të largohesh nga mëkati ndaj Allahut me dritë nga Allahu, t'i frikësohesh dënimit të Allahut" Thotë Ibnul-Kajjimi kur e shpjegon këtë thënie: "Kjo është gjëja më e mirë që është thënë në lidhje me përkufizimin e takvallëkut, ngase çdo punë patjetër duhet të ketë pikënisje dhe

Allahu i ka cilësuar robërit e Tij të zgjedhur me besim:

“Por Allahu jua bëri të dashur juve besimin dhe jua ka zbukuruar atë në zemrat tuaja, ndërsa jua ka bërë juve mosbesimin, shfrenimin dhe mëkatën të urryer për ju. Mu këta janë ata të udhëzuarit drejtë. (Kjo është) mirësi prej Allahut dhe begati. Dhe Allahu është i Gjithëditur, më i Urti Gjykues.” (El Huxhurat 7 dhe 8)

Kjo është dhuntia më e mirë, t’ia bëjë të dashur Allahu robët imanin, t’ia zbukurojë atë në zemrën e tij, t’ia mundësojë ta shijojë ëmbëlsinë e tij, e gjymtyrët e trupit të tij t’i nënshtrohen ritualeve islame, si dhe t’ia bëjë të urryer atij të ndaluarat.

E Allahu e di se kush e meriton të shpërblehet me këtë dhunti, Ai është i Urtë dhe këtë ia jep vetëm atij që e meriton.

Hadithi i vërtetë të cilin e përcjell Enesi, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë se i Dërguari i Allahut, paqja e Allahut qoftë mbi të, ka deklaruar:

“Ai tek i cili gjenden tri gjëra e ka shijuar ëmbëlsinë e imanit: të jenë Allahu dhe i Dërguari i Tij më të dashur për të se çdo

qëllim, e një punë nuk është nënshttrim ndaj Zotit dhe afrim tek Ai përderisa të mos jetë burim dhe motiv i asaj pune imani e jo adeti, hevaja (epshi), kërkimi i lavdërimit dhe i pozitës, e të ngjashme, dhe pikënisje e tij duhet të jetë vetëm imani e qëllimi i tij shpërblimi i Allahut dhe kërkimi i kënaqësisë së Tij, e kjo pra është shpresimi në Të. Mu për këtë, shpeshherë këto dy elemente nëpër hadithe i hasim bashkë, për shembull Pejgamberi, alejhis-selam. thotë: “Kush e agjëron Ramazanin me besim (iman në Allahun) dhe duke shpresuar në të, i falen atij mëkatet e kaluara” etj. Fjala e tij “me dritë nga Allahu” aludon në elementin e parë: imanin, i cili është burimi, shkak dhe motivi i punës. Kurse fjala e tij “të shpresosh shpërblimin e Allahut” aludon në elementin e dytë: të shpresuarit, i cili është qëllimi i kësaj pune.” (Er-Risaletut-Tebukijjeh)

gjë tjetër, ta dojë njeriun vetëm e vetëm për Allahun dhe ta urrejë të braktisë fenë e tij siç urren të hidhet në zjarr.”¹⁰

Hadithi e cek burimin e imanit, i cili është: të duhet Allahu dhe i Dërguari i Tij, dhe jo vetëm kaq, por kjo dashuri duhet të jetë mbi çdo dashuri tjetër. Pastaj ceken degët e saj: të duhet për Allahun dhe të urrehet për hir të Allahut, pra të duhen pejgamberët, besimtarët e vërtetë, shehidët dhe besimtarët e mirë, ngase ata e donë Allahun dhe vetë Allahu i ka veçuar ata nga robërit e Tij.

Pastaj ceket e kundërta e kësaj: të urrehet shumë braktisja e fesë së tij, më tepër sesa urrehet hedhja në zjarr. Në këtë hadith Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, ka treguar se imani ka një ëmbëlsi në zemër, të cilën ëmbëlsi nëse e gjen njeriu i mjafton nga të dashurat e dynjasë dhe nga qëllimet vetjake, dhe atij i siguron një jetë të mirë. Ngase kush e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij, atëherë gjuha e tij pa vështirësi e përmend Allahun - meqë kush e do një gjë ai e përmend shumë atë - përpiqet ta pasojë të Dërguarin e Allahut dhe pasimit të tij i jep përparësi ndaj çdo fjale, dëshire shpirtërore dhe qëllimi tjetër. Ai i cili posedon shpirt të këtillë është i qetë, i nënshtrueshëm, e zemra e tij është e hapur ndaj Islamit, e ai njeri është në dritë nga Zoti i tij. Por shumë nga besimtarët nuk e arrijnë këtë shkallë të lartë.

“Për të gjithë do të ketë shkallë sipas punëve që kanë vepruar.” (El En’am, 132)

Janë veçuar këto tri kategori njerëzish në këtë hadith, ngase këto veti gjenden vetëm tek ata të cilëve zemra u është

¹⁰ E transmeton Buhariu, dhe Muslimi me dallim të vogël.

shndritur me dritën e imanit dhe të bindjes, dhe atyre u janë qartësuar të mirat e këtyre vetive, e kjo njohuri ka imponuar që tek ata të gjenden këto veti. Thotë dijetari, El Kurtubijj:

“Ky hadith na bën të ditur se dashuria e besimtarit, e cila mundëson të shijohet ëmbëlsia e imanit, patjetër duhet të jetë sinqerisht për Allahun, e jo e përzier me ndonjë qëllim dynjallëku a interesi njerëzor, ngase kushdo që e do besimtarin për këto qëllime dhe interese dashuria e tij pushon me të arriturit e këtyre qëllimeve ose pushon ngase ai nuk shpreson t’i arrijë ato qëllime, mirëpo dashuria ndaj besimtarit është diçka e vazhduar pavarësisht nga ato qëllime dhe interesa. E kur të merret dashuria si mjet për të arritur ndonjë interes material, atëherë pak shijohet kjo ëmbëlsi, bile mund të humbë fare, sidomos në këtë kohë kur shumë gjurmë të imanit janë fshirë. Me një fjalë, dashuria ndaj besimtarit është një ndër ibadetet (adhurimet e Allahut) që gjithsesi duhet të bëhen me qëllim (nijjet) të sinqertë. (El mufhem, fq. 214 dhe 215)

Po ashtu, në Përmbledhjen e haditheve sahih të Buhariut dhe Muslimit përcillet nga Ebu Hurejra se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Imani i ka shtatëdhjetë e disa pjesë (degë), më e larta e të cilave është fjala La ilahe il-lallah (Nuk ka të adhuruar me meritë pos Allahut), e më e ulëta është largimi i pengesës nga rruga. Edhe turpi është pjesë e imanit.”¹¹

Ky hadith qartë tregon se imani përmban fjalët e gjuhës, të gjymtyrëve, të besimit dhe moralin, kryerjen e detyrimeve ndaj All-llahut dhe bamirësinë ndaj krijesave të Tij. Në këtë hadith përmendet dega më e lartë e imanit dhe themeli i tij, e kjo është fjala La ilahe il-lallah (Nuk ka të adhuruar me

¹¹ Buhariu dhe Muslimi. Ky është teksti nga Muslimi, kurse tek Buhariu qëndron:

“Imani i ka gjashtëdhjetë e disa pjesë (degë). Edhe turpi është pjesë e imanit”.

meritë pos Allahut) me besim e sinqeritet, dhe përmendet dega më e ulët, e ajo është largimi i një guri, i një therre, e çdo gjë që pengon nga rruga. E sa e sa bamirësi janë më të mëdha se kjo. Në fund përmendet turpi, ngase ai është jeta e imanit me të cilin njeriu lë çdo punë të shëmtuar, dhe me të realizon çdo moral të mirë. Allahu e di më së miri.

E këto pjesë të imanit, të përmendura në hadith, përfshijnë të gjitha ligjet e fesë, të dukshmet dhe të fshehtat. Thotë El-Kadi Ijjadi:

“Një grup dijetarësh janë përpjekur t’i numërojnë në detaje këto pjesë, edhe pse kjo është një gjë e vështirë, sidoqoftë mosnjohja e këtyre pjesëve në detaje nuk e dëmton imanin e njeriut.”

Ata që i kanë numëruar këto pjesë veç e veç nuk janë pajtuar të gjithë në një fjalë. Më i sakti prej tyre është numërimi i Ibn Hibbanit, por këtu nuk do ta citojmë sqarimin e tij dhënë se cilës, mirëpo vetëm do ta përmendim secilën. Ai thotë se këto pjesë degëzohen në tri kategori kryesore: vepra të zemrës, vepra të gjuhës dhe vepra të trupit.

Në veprat e zemrës, ku bëjnë pjesë besimet dhe qëllimet (nijjetet), hyjnë njëzet e katër degë:

Besimi në Allahun, e këtu hyn: besimi në qenien e Tij, në cilësitë e Tij, në njëjësinë e Tij, besimi se asgjë nuk i përngjan Atij dhe besimi se çdo gjë pos Tij është e krijuar;

1. Besimi në melaqet e Tij;
2. Besimi në Librat e Tij;
3. Besimi në të Dërguarit e Tij;
4. Besimi në pyetjen në varr, në ngritjen nga varri, në tubim, në llogari dhe peshojë (mizan, caktimin e Tij, qoftë i mirë a i keq;

5. Besimi në Ditën e Fundit, këtu hyn: besimi në urën përmbixhennem (sirat), nëxhennet dhe xhennem;
6. Dashuria e Allahut;
7. Të duhet dhe të urrehet për Allahun;
8. Dashuria e Pejgamberit dhe besimi në madhësinë e tij, këtu hyn: të përshëndeturit (salavat) e tij (kjo bëhet me fjalët Allahumme sal-li ala Muhammed ose alejhis-salam ose sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, e të ngjashme, që në shqip kanë kuptim: paqja, shpëtimi dhe mëshira e Allahut sh.p.) dhe pasimi i sunnetit të tij. (sunneti do të thotë porositë, urdhrat, veprat dhe traditat e të Dërguarit Muhammed. sh.p.)
9. Singëriteti, këtu hyn: lënia e syfaqësisë (rijasë) dhe e dyfytërisë (nifakut);
10. Pendimi tek Allahu;
11. Frika nga Allahu;
12. Shpresa në Allahun;
13. Falënderimi i Allahut;
14. Përmbushja e premtimit;
15. Durimi;
16. Kënaqja dhe pajtimi me caktimin e Allahut, fatin;
17. Mbështetja në Allahun;
18. Mëshira;
19. Modestia, këtu hyn: respektimi i të madhit dhe mëshirimi i të voglit;
20. Largimi nga mendjemadhësia dhe nga vetëpëlqimi;
21. Largimi nga zilia; argimi nga zilia me armiqësim;
22. Largimi nga zemërimi.

Në veprat e gjuhës hyjnë shtatë degë:

1. Shqiptimi i njëjesisë së Allahut (i fjalës La ilahe il-Allah - S'ka të adhuroar me meritë pos Allahut);
2. Leximi i Kuranit;
3. Mësimi i Fesë;
4. Mësimi i Fesë të tjerëve;
5. Lutja e Allahut;
6. Përmendja e Allahut (dhikri), këty hyn edhe kërkimi i faljes nga Allahu (istigfari);
7. Braktisja e së padobishmes (fjalë a punë).

Veprat e trupit, ku hyjnë 38 pika, ndahen në tri grupe:

Grupi i parë:

1. Pastrimi i trupit, këtu hyjnë: largimi nga fëlliqësitë;
2. Mbulimi i pjesëve të turpshme të trupit (avretit);
3. Namazi i detyrueshëm (farz) dhe vullnetar (nafi);
4. Zeqati;
5. Lirimi i robit;
6. Bujaria, këtu hyjnë: dhënia e ushqimit dhe nderimi i mysafirit;
7. Agjërimi i detyrueshëm (farz) dhe vullnetar (nafi);
8. Haxhi dhe Umra;
9. Tavafi (sjellja rreth Ka'bes);
10. I'tikafi (qëndrimi në xhami dhjetë netët e fundit të ramazanit për t'iu përkushtuar adhurimit të Zotit);
11. Kërkimi i Natës së Kadrit duke e adhuroar Zotin;
12. Ikja për ta ruajtur fenë, këtu hyjnë: shpërngulja (hixhreti) nga vendi i shirkut (shirk do të thotë të

adhurohet dikush tjetër me Allahun, t'i kushtohet ndonjë nga format e adhurimit (ibadetit) dikujt tjetër pos Allahut);

13. Përmbushja e zotimit;
14. T'i jepet përparësi anës së djathtë;
15. Kryerja e shpagimit për mëkate (kefaret)

Grupi i dytë:

1. Martesa;
2. Kryerja e detyrimeve ndaj gruas dhe fëmijëve;
3. Bamirësia ndaj prindërve, këtu hyn: largimi nga mosrespektimi i tyre;
4. Edukimi i fëmijëve;
5. Ruajtja e lidhjeve farefisnore; Nënshtrimi ndaj zotëriut (për robin);
6. Butësia me robin;

Grupi i tretë:

1. Drejtësia në qeverisje;
2. Pasimi i Grupit (xhematit) të drejtë;
3. Nënshtrimi kryetarëve (halifes);
4. Përmirësimi i marrëdhënieve të njerëzve, këtu hyjnë vrasja e havarixhëve dhe e tiranëve;
5. Ndhimesa në të mira, këtu hyjnë: thirrja në punë të mira dhe ndalimi nga të këqijat;
6. Zbatimi i dënimeve të parapara sipas Sheriatit;
7. Lufta në rrugë të Allahut (xhihadi), këtu hyjnë edhe ruajtja e kufirit me armikun;

8. Përmbushja e amanetit; dhënia e 1/5 nga plaçka e luftës;
9. Kthimi i borxhit;
10. Ndhima e fqinjtit;
11. Sjellja e mirë me njerëz;
12. Harxhimi i pasurisë me vend dhe aty ku duhet, këtu hyjnë: largimi nga koprracia dhe nga harxhimi i tepërt;
13. Kthimi i selamit (përshëndetjes);
14. Lutja për atë që teshtin (i thuhet Allahu të mëshiroftë - jerhamukAllah);
15. Mosbezdisja e njerëzve;
16. Braktisja e punëve joserioze dhe të kota, dhe
17. Largimi i pengesës nga rruga.

Këto pra janë 69 degë, e mund të llogariten si 79, nëse disa nëndegë numërohen si degë të veçanta (Fet-hul-Bari, 1/52 dhe 53).

Kjo gjithashtu tregon qartë se imani shtohet e pakësohet varësisht nga shtimi, respektivisht pakësimi i këtyre pjesëve dhe ligjeve të njeriu. Pa dyshim, te disa njerëz gjendet një numër më madh i këtyre pjesëve (degëve), ndërsa te disa një numër më vogël.¹² Së këndejmi, kush thotë se imani nuk shtohet as nuk pakësohet ai e ka kundërshtuar këtë gjë që ne e shohim me sytë tanë, e i ka kundërshtuar edhe tekstet kur'anore dhe të hadithit siç poshohet.

Pejgamberi ka treguar për domethënien e Islamit dhe të imanit në hadithin e njohur të Xhibrilit, kur ai në prani të sahabëve e pyeti për imanin, e Pejgamberi u përgjigj:

¹² Prandaj ai i cili realizon një numër më të madh të këtyre pjesëve thuhet se e ka imanin më të shtuar se ata që realizojnë një numër më të vogël të këtyre pjesëve. (sh.p.)

“(Imani është) Të besosh në Allahun, në melaiket e Tij, në Librat e Tij, në të dërguarit e Tij në Ditën e Fundit dhe në caktimin e Zotit.”¹³

Ndërsa islamin e interpretoi me pesë shtyllat e dukshme (me shqiptimin e La ilahe il lallah, me faljen e namazit dhe të tjerat), ngase, siç u cek më herët, kur të përmendet imani bashkë me Islamin, imani interpretohet si besime fetare që janë në zemër, ndërsa Islami si rite të dukshme a të jashtme fetare. Ndërsa kur të përmende vetëm islami a vetëm imani veç e veç, jo së bashku, atëherë secili prej tyre përfshin të gjitha këto të dyja, edhe besimet edhe ritet.

Në dy përmbledhjet e sahihave përcillet hadithi nga Enesi, se Pejgamberi, paqja e Allahu qoftë mbi të, ka thënë:

“Nuk është besimtar dikush nga ju përderisa të jem unë për të më i dashur se prindi i tij, se fëmija i tij dhe se gjithë njerëzit.”¹⁴

¹³ E shënon Muslimi, siç përcillet nga Ibn Umeri, Allahu qoftë i kënaqur me të.

¹⁴ Buhariu dhe Muslimi. Ky hadith, edhe pse i shkurtër, përmban llojet e dashurisë, të cilat janë tri:

1. Dashuria që bëhet për ta madhëruar të dashurin, siç është për shembull dashuria ndaj prindit, dijetarëve, njerëzve me vlerë etj.
2. Dashuria e mëshirës dhe mallit, siç është dashuria ndaj fëmijës, dhe
3. Dashuria që shfaqet kur dikush dëshiron të bëhet a të duket si tjetërkush, për shkak se e sheh si të mirë atë person.

Dashuria ndaj Pejgamberit duhet t'i përfshijë që të tri llojet e përmendura. Për shkak se Allahu atë e ka bërë njeri të përsosur dhe e ka ngritur përmbi njerëzit e tjerë, me cilësi, moral, sjellje e personalitet të mirë, prandaj ai është më i përsosuri ndër ata që kanë shkelur tokën, më i miri që ka ecur dhe ka kalëruar, më i ndershmi në Ditën e Kiametit dhe njeriu më i lartë në botën e ardhme.

(El-Mufhem, El-Kurtubi. 1/225)

Në këtë hadith Pejgamberi jep të kuptojmë se nëse ndeshen tek një njeri dy dëshira të kundërta me njëra-tjetrën, e njeriu i jep përparësi asaj që e do i Dërguari i Allahut, ai ka besim të vërtetë, dhe se në të kundërtën ai ka besim të mangët. Siç thotë Allahu:

“Por jo, për Zotin tënd! Ata nuk mund të kenë aspak besim përderisa të të bëjnë ty (o Muhammed a.s.) gjykues për të gjitha mosmarrëveshjet mes tyre, derisa të mos mbetet në veten e tyre asnjë pikë kundërshtimi ndaj vendimeve të tua dhe derisa t’i pranojnë ato (vendimet e tua) plotësisht të nënshtruar.” (En-Nisa, 65).

Allahu betohet se ata nuk janë besimtarë derisa ta marrin të Dërguarin e Tij për gjykatës, e pastaj të mos mbetet në zemrat e tyre pakënaqësi dhe jorehati nga gjykimi i tij dhe derisa plotësisht t’i nënshtrohen, ta pasojnë atë dhe ta pranojnë gjykimin e tij. Gjykimi në fjalë përfshin bazat e fesë dhe degët e saj, si dhe çështjet e tjera botërore.

Në dy sahihat, po ashtu nga Enesi, përcillet se i Dërguari i Allahut, paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë:

*“Nuk është besimtar dikush prej jush, derisa të dojë për vëllain e tij atë që do për veten.”*¹⁵

Me këtë dashuri nënkuptohet që muslimani t’i kryejë detyrimet ndaj vëllezërve të tij muslimanë, ngase kjo është pjesë e, imanit. E kushdo që nuk i kryen këto detyra, e nuk ia do vëllait atë që vetes ia do, i tilli nuk beson ashtu siç kërkon feja islame të besohet, por besimi i tij është i mangët, aq sa është i mangët në detyrat me të cilat është ngarkuar.

¹⁵ Buhariu dhe Muslimi. Thotë El-Kermanijju, gjithashtu iman është edhe te urresh për vëllanë tënd te këqijat që i, urren për vetvete, gjë që në hadith nuk përmendet por nënkuptohet domosdoshmërisht.

Në sahih përcillet se Abbas ibën Abdulmutalib ka thënë:
«Ka thënë i Dërguari i Allahut:

*“E ka shijuar shijen e imanit ai që është i kënaqur me Allahun për Zot, me Islamin për fe dhe me Muhammedin për pejgamber.”*¹⁶

Kënaqësia me këto do të thotë gëzim dhe lumturi me hyjninë e Allahut dhe me caktimin e Tij, me Islamin si fe, andaj muslimani i gëzohet kësaj dhe e falendëron Allahun për këtë dhunti, e cila vërtet është dhuntia më e madhe, sepse Allahu e ka bërë të jetë i kënaqur me Islamin dhe e ka zgjedhur t’i ndihmojë në këtë; dhe të jetë i kënaqur me Muhammedin për Pejgamber, sepse ai është njeriu, më i përsosur dhe më i lartë në çdo aspekt, e populli (ummeti) dhe pasuesit e tij janë populli më i mirë e më i ngritur në dynja dhe në botën e ardhshme.

Njëherazi, kënaqja me profetësinë e Muhammedit, me misionin e tij dhe pasimi i tij është një nga shkaqet më të mëdha që e ngjallin besimin dhe njeriu me anë të kësaj e ndien shijen e imanit. Allahu i Lartë thotë:

“Vërtet Allahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve kur Ai çoi ndërmjet tyre një të dërguar (Muhammedin) nga mesi i tyre, që t’u lexojë atyre vargjet e Tij (Kuranin), t’i pastrojë ata (nga mëkatet), t’ua mësojë Librin (Kuranin) dhe Urtësinë (Sunnetin), përderisa para kësaj ata ishin në humbje të qartë.” (Ali Imran, 164)

¹⁶ Muslimi dhe Tirmidhiu. Thotë Kadi El-Ijjad: “Kuptimi i këtij hadithi është se imani i tij është i vërtetë, shpirti i tij gjen prehje në të dhe imani e deh brendësinë e poseduesit të tij.

“Juve ju erdhi një i dërguar nga mesi juaj (të cilin ju e njihni mirë). Atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, është i merakosur dhe lakmues për ju (të udhëzoheni, t’i luteni Allahut, t’ju falë Allahu gjynahet, të futeni në xhennet etj.) dhe i ndjeshëm e i mëshirshëm me besimtarët.” (Et-Teubeh, 128)

E si të mos kënaqet njeriu me këtë të Dërguar bujar, të ndieshëm e të mëshirshëm, për të cilin Allahu është betuar se është në një shkallë të lartë morali?! Titulli më i mirë i njeriut është rob i Allahut dhe pasues i të Dërguarit të Tij. Kjo njëherazi është shenjë se Allahu e do këtë njeri, kurse dashuria e njeriut për Allahun dhe besimi i tij në Të vërtetohet me pasimin e të dërguarit të tij. Allahu thotë:

“Thuaj (o Muhammed): Nëse vërtet e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, Allahu do t’ju dojë ju dhe do t’ju falë mëkatet tuaja.” (Ali Imran, 31)

Përcillet nga Sufjan ibn Abdullah Eth-Thekafij se ka rrëfyer: *“Pyeta: O i Dërguar i Allahut! Ma thuaj një fjalë në Islam, për të cilën s’kam nevojë ta pyes askënd pas teje! Tha: -Thuaj: Besoj në Allahun, pastaj qëndro paluhatshëm në këtë!”*¹⁷

Me këtë këshillë gjithëpërfshirëse Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, qartëson se njeriu kur të pranojë besimin në formë të dukshme e të fshehur, e pastaj qëndron në të me fjalë e me vepra, me punë e me ndalim nga haramet, ai është në Rrugën e drejtë dhe shpresohet që i tilli të hyjë në xhennet me ata për të cilët Allahu thotë:

¹⁷ Muslimi.

“Vërtet se atyre që thonë: ‘Zoti ynë është Allahu’, dhe pastaj qëndrojnë të paluhatur në këtë, tek ata do të ulen melekët (duke u thënë në kohën e marrjes së shpirtit): ‘Mos kini frikë, as mos u pikëlloni! Por merrni myzhden e përgëzimit me xhennet i cili ju qe premtuar! Ne kemi qenë miqtë tuaj në këtë botë dhe jemi të tillë edhe në jetën e fundit. Atje ju do të keni gjithçka që do t’ju dëshirojë shpirti dhe për ju atje do të ketë çfarë të kërkonti. Kënaqësi nga (Allahu), gjithnjë Falës i Madh, Mëshirëplotë’.” (Fussilet 30-32)

Në hadithin që e përcjell Ibn Abbasi thuhet se kur ka ardhur delegacioni i Abulkajsit te Pejgamberi, paqja e Allahut goftë mbi të, i kanë thënë:

“Na urdhëro me diçka që t’ua përcjellim edhe të tjerëve e të hyjmë në xhennet!” Pastaj e pyetën për pijet, e ai i urdhëroi me katër gjëra e i ndaloi nga katër të tjera. I urdhëroi të besojnë në Allahun e vetëm dhe u tha: “A e dini se ç’është besimi (imani) në Allahun e vetëm». Ata thanë: «Allahu dhe i Dërguari i Tij më së miri e dinë». U tha: «Ai është dëshmia se nuk ka të adhuruar pos Allahut dhe se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij, falja e namazit, dhënia e zeqatit, agjërimi i ramazanit dhe të japësh një të pestën e plaçkës së luftës”. Dhe i ndaloi nga katër tjera... dhe u tha: “Mësoni këto e ua përcillni të tjerëve!”

Edhe ky hadith gjithashtu tregon se ritet e dukshme fetare janë pjesë të imanit, siç është namazi, zeqati, agjërimi dhe dhënia e një të pestës së plaçkës së zënë në luftë. Krejt kjo na e tregon domethënien e imanit dhe e zgjidh problemin, prandaj ashtu siç hyjnë në iman besimet e zemrës, po ashtu në iman hyjnë edhe veprat e trupit. Me një fjalë çdo gjë që

afron tek Allahu, qoftë fjalë, punë a besim është pjesë e imanit ose iman.

Në sunenin e Ebu Davudit, nga Ebu Umameh përcillet se ka treguar: *“Ka thënë i Dërguari i Allahut: ‘Kush do për Allahun, urren për Allahun, jep për Allahun dhe nuk jep për Allahun imani i tij është i plotë.’”*

Dashuria dhe urrejtja është në zemër dhe e fshehur, ndërsa dhënia dhe mosdhënia është diçka e dukshme, e jashtme. Që gjithë këto të llogariten si forma të adhurimit të Allahut dhe që Allahu të shpërblejë për to, kushtëzohet që të jetë qëllimi i sinqertë, që është shpirti, esenca dhe fshehtësia e imanit.

Dashuria për Allahun do të thotë të duhet Allahu, të duhen ato punë, kohë, gjendje që Allahu i do, dhe të duhen peygamberët dhe pasuesit e tyre që Allahu i do.

Të urrehet për Allahun do të thotë të urrehet çdo gjë që Allahu urren, qoftë ajo mosbesim a mëkat, dhe të urrehet çdo kush që cilësohet me të njëjat a thërret në to.

Dhënia për Allahun përfshin gjithë atë që njeriu është urdhëruar të japë nga pasuria, nga munda, koha dhe vetja e tij. Allahu thotë:

“E sa i përket atij që jep dhe ruhet (nga dënimi i Allahut) e i frikësohet Allahut dhe beson në të mirën (në La ilahe il-lallah, - Nuk ka të adhuruar me meritë përpos Allahut), atëherë Ne do t ia bëjmë të sheshtë atij rrugën e lehtë (të mirësisë) do t’ia lehtësojmë atij të lehtën (punët e mira).” (El-Lejl, 5-7).

Kjo “dhënie” përfshin krejt atë me të cilën është urdhëruar njeriu dhe nuk përkufizohet vetëm me dhënie të

pasurisë, edhe pse kjo është një pjesë e dhënies. Po kështu, edhe mosdhënia për Allahun... Me këto katër punë njeriut i plotësohet imani (besimi) dhe feja e tij.

Në përmbledhjen e Tirmidhiut dhe të Nesaiut gjendet një hadith sahih (i vërtetë) që e përcjell Ebu Hurejra, në të cilin Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: *“Besimtar (i vërtetë) është ai prej të cilit janë të sigurt gjaku dhe pasuria e njerëzve.”*

Hadithi tregon se besimi i vërtetë e shtyn pronarin e tij ta ruajë amanetin dhe e ndalon nga tradhtia, e njerëzit janë të sigurt prej tij, sepse gjërat më të vlefshme të tyre janë të sigurt prej tij - gjaku dhe pasuria e tyre.¹⁸

Këto hadithe e sqarojnë domethënien e besimit (imanit) dhe realitetin e tij. Thënë shkurt, ai është, siç ka thënë Hasen El-Basriu dhe të tjerët: *“Nuk është besimi (imani) shpresim e as zbukurim, mirëpo ai është diçka që zë vend në zemër dhe që punët e vërtetojnë.”*

Pra, veprat e dukshme dhe të fshehurat e vërtetojnë imanin dhe me to ai realizohet. Allahu thotë:

“E kush beson në Allahun, Ai e udhëzon zemrën e tij.”
(Et-Tegabun, 11)

Kur ta godasë njeriun një fatkeqësi dhe beson se ajo është nga Allahu dhe se ajo ka ndodhur nga urtësia dhe mëshira e Allahut dhe se Ai më së miri e di çfarë është mirë për robin

¹⁸ Krahaso me këtë udhëzim profetik disa grupe muslimanësh të cilët pandehin të jenë grupe të xhihadit islamik, duke i frikësuar të sigurtit dhe duke derdhur gjakun e muslimanëve dhe të jomuslimanëve pa të drejtë! Kjo e shëmton fotografinë e besimtarëve dhe i jep rast armiqtëve të muslimanëve ta etiketojnë Islamin si terrorizëm dhe ekstremizëm. Ne jemi të Allahut dhe tek ai do të kthehemi! (Shprehje që thuhet në rast fatkeqësie.)

e Tij, Allahu atëherë ia udhëzon zemrën atij në durim, që të pajtohet me këtë fat dhe të qetësohet.

Allahu thotë:

“Pa dyshim se ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira, Zoti i tyre do t i udhëzojë për shkak të besimit të tyre.”
(Junus, 9)

Në këtë ajet kur’anor nuk është cekur se në çka i udhëzon Zoti këta besimtarë, në mënyrë që të mos kufizohet udhëzimi vetëm në një gjë, por të kuptohet se ky udhëzim është në të gjitha të mirat dhe udhëzim që i largon nga të gjitha të këqijat, për shkak të besimit (imanit) të tyre.

U kuptua pra, se veprat nga njëri aspekt janë pjesë të imanit, e nga aspekti tjetër janë fryt dhe domosdoshmëri të imanit, Allahu na udhëzoftë!

All-llahu thotë:

“Allahu kurrë nuk do t’jua humbasë imanin (besimin) tuaj. Vërtet që Allahu është i Butë dhe i Mëshirshëm me njerëzimin.” (El Bekarah, 143)

Shumë komentatorë të Kur’anit e kanë interpretuar besimin (imanin) që përmendet në këtë ajet si namazi i falur nga kibla e parë e muslimanëve - xhamia në Kuds (Jerusalem) para se të ndërrohej ajo dhe të bëhej pasandaj Ka’ba në Mekke kible për muslimanët. Shumë njerëz nga muslimanët vdiqën para se të zbriste urdhri për faljen në drejtim të Ka’bes në Mekke, prandaj te disa kjo shkaktoi dyshim nëse do Tua pranojë Allahu atyre atë namaz të falur nga xhamia në Kuds.¹⁹

¹⁹ Shih Fet-hul Bariij 1/95-98.

Është quajtur namazi këtu besim, ngase ai është formë e nënshtrimit dhe e respektimit të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, e pikërisht kjo është besim.

Po ashtu, nga ky ajet nxirren disa mësimë:

- Myzhdja e madhe. Ajo është se Allahu nuk e humb besimin e besimtarëve, qoftë ai besim pak a shumë, siç thuhet në hadithin sahih: “Allahu do ta nxjerrë nga zjarri çdokënd në zemrën e të cilit gjendet një grimcë e besimit (imanit) sa kokrra e drithit.”²⁰

- Gjithashtu në të ka myzhde për çdokënd që e bën një punë në shenjë respekti për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, nëse ashtu mendon se kërkohet nga ai, ose edhe nëse gabimisht e bën atë punë, ose e bën atë pasi që puna përkatëse të jetë shfuqizuar.

Ngase ai e ka bërë atë punë për shkak se ka besuar në Allahun dhe ka pasur për qëllim me të t’i nënshtrohet Allahut, mirëpo ai e ka kuptuar punën përkatëse gabimisht dhe e ka punuar gabimisht. Ky gabim i falet atij, e Allahu nuk ia humb shpërblimin për qëllimin e tij që ka pasur, d.m.th. t’i nënshtrohet Allahut. Prandaj, thotë Allahu për besimtarët:

«Zoti ynë, mos na qorto për atë që e harrojmë dhe gabojmë!» (El-Bekare, 286)

E Allahu tha me gjuhën e të Dërguarit të Tij: “Ua kam falur.”²¹ Në një hadith sahih thuhet: «Kur të japë mundin e

²⁰ E shënon Buhariu dhe Muslimi.

²¹ E transmeton Muslimi nga Ibn Abbasi që thotë: «Pasi që zbriti ajeti «... e nëse e shfaqni apo e fshihni atë që gjendet në ju Allahu do tju llogaritë për këtë». (El-Bekare. 284), Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, tha: Thoni: “Dëgjuam, respektuam dhe u dorëzuam!” E Allahu e futi imanin në zemrat e tyre, pastaj Allahu e zbriti: “Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij. Atij i takon ajo që e fitoi dhe atij i bie ajo (e keqe) që e meritoi. Zoti ynë,

tij gjyqtari, gjykon dhe ia qëllon, atij i takojnë dy shpërblime. Ndërsa kur të japë mundin e tij, gjykon, por gabon, atij i takon vetëm një shpërblim, kurse gabimi i falet.” Po ashtu, kush vendos të bëjë një punë të mirë dhe do që ta bëjë atë, por diçka e pengon, sëmundje, udhëtim, pamundësi etj., i shkruhet atij ky qëllim (nijjet). Në Sahihun e Muslimit përcillet hadithi nga Ebu Musa:

“Kushdo që sëmuret ose gjendet në udhëtim (dhe kjo e pengon nga adhurimi i tij i zakonshëm) i shkruhet ajo që e ka bërë përderisa ka qenë i shëndoshë, respektivisht në shtëpi.”²²

Kjo vlen edhe për atë të cilin pleqëria e pengon nga një punë që përndryshe e ka bërë vazhdimisht.

IMANI SHTOHET DHE PAKËSOHET

Kur të vërtetohet kuptimi i imanit nga Kur’ani dhe Sunneti, se ai është fjalë kuptimi i së cilës përfshin të gjitha ligjet islame, bazat e tij dhe sinqeritetin, bile ai është krejt Feja, kur të vërtetohet kjo, atëherë është e ditur se ai shtohet e pakësohet, forcohet e dobësohet. Kjo çështje është e padiskutueshme dhe nuk pranon asfarë dyshimi, ngase tekstet e Kur’anit dhe Sunnetit qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë tregojnë se imani shtohet e pakësohet.

mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë! - Tha (Allahu): E bëra këtë. - Zoti ynë, mos na ngarko neve barrë të rëndë siç i ngarkove ata që ishin para nesh! - Tha (Allahu): E bëra këtë. - Zoti ynë, mos na ngarko me atë për të cilën ne nuk kemi fuqi! - Tha (Allahu): E bëra këtë. - Na i fshi mëkatët, na fal, na mëshiro, Ti je Mbrojtësi dhe Përkrahësi ynë! - Tha (Allahu): E bëra këtë.” (El-Bekare, 286).

²² Hadithin nuk e shënon Muslimi, por Buhariu me këtë tekst: “Kur të sëmuret robi a udhëton i shkruhet...”

Po marrim shembuj ajetet nga Kur’ani që e vërtetojnë këtë:

“...që atyre t’u shtohet besimi imanit të tyre që patën...”
(EIFet-h, 4);

“...dhe që besimtarët të shtojnë besimin (imanin)...”
(EIMuddeththir, 31);

“Ata (besimtarë) të cilëve njerëzit (hipokritët) u thanë: ‘Vërtet populli (pagan) ka grumbulluar kundër jush (një ushtri të madhe), kështu që frikësojuni atyre!’ Por kjo në të vërtetë vetëm ua shtoi besimin (imanin) dhe thanë: ‘Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Mbrotësi më i mirë.’” (Ali Imran, 173);

“Dhe sa herë zbret ndonjë sure (e Kur’anit) disa prej tyre (hipokritëve) thonë: ‘Cilit prej jush iu shtua besimi?’ Sa për ata që besojnë, ajo e ka shtuar besimin (imanin) e tyre dhe ndiejnë kënaqësi.” (Et-Teube, 124) etj.

Po ashtu edhe realiteti e dëshmon këtë prej të gjitha aspekteve të imanit. Ngase njerëzit ndryshojnë për nga njohja dhe dija për imanin, si dhe për nga morali dhe veprat e tij. Këto aspekte ndryshojnë te njerëzit për nga fuqia dhe sasia e të njëjtave, si dhe për nga gjurmët që ato lënë në jetën dhe sjelljen e njeriut etj. Me fjalë të tjera, disa muslimanë dhe besimtarë kanë njohuri më të mëdha për shkencat e besimit, besimi i tyre lë gjurmë më shumë dhe më të mëdha në jetën dhe sjelljen e tyre, bëjnë vepra që burojnë nga ai besim dhe stolisen me moralin që buron nga ai.

Prandaj, besimtarët me besim të plotë e njohin besimin, dinë për të në hollësi dhe veprojnë punë të besimit, përkundër shumë besimtarëve të cilët nuk gjendet ajo sasi e njohjes ose e dijes për besimin dhe e veprimeve sipas tij. Shumë besimtarë, pra, e njohin besimin vetëm sipërfaqësisht dhe dinë për të vetëm gjërat e përgjithshme, ndërsa vepra të besimit kanë pak. Shumë të atillë kanë kundërshtime, dyshime e epshe që e dobësojnë besimin e tyre dhe e pakësojnë atë dukshëm. Bile gjejmë besimtarë dija e të cilëve ndryshon nga njëri-tjetri: disa kanë dituri të vërtetë për besimin pa kurrfarë dyshimi, të tjerët kanë dituri të dobët e shumë kundërshtime që e dobësojnë besimin e tyre edhe më. Po ashtu, morali i imanit (virtytet: butësia, durimi, sjellja e mirë etj.) nuk është tek të gjithë e njëjtë. Gjithashtu gjendja është e tillë edhe me ritualet (ibadetet) e dukshme. Për shembull me namazin: dy veta e falin një namaz, njëri prej tyre i kryen me përkushtim elementet e dukshme dhe të fshehura të tij, dhe e adhuron Allahun sikur ta shihte Atë, dhe e di se edhe pse ai nuk e sheh Allahun, Allahu e sheh atë, ndërsa tjetri e fal namazin vetëm në formë të jashtme, kurse në brendi është i zënë me diçka krejtësisht tjetër. Kjo është kështu edhe me ritualet e tjera.

Prandaj, besimtarët janë tri kategorish:

1. Kategoria e të parëve,
2. Kategoria e të mesëmve, dhe
3. Kategoria e atyre që i bëjnë zullum vetvetes.

Edhe brenda secilës nga këto tri kategori ka ndarje dhe dallime mes njerëzish. Aq më shumë, secili besimtar si individ ka raste dhe kohë kur vepron më shumë punë besimi, mirëpo ka kohëra kur ndodh e kundërta. Besimtarët e mirë të cilët i

kushtojnë rëndësi besimit, e përtërijnë atë në çdo kohë dhe përpiqen ta rrisin e ta forcojnë atë, i largojnë ato gjëra që e kundërshtojnë besimin dhe që shkaktojnë pakësimin e tij. Në këtë drejtim ata japin mund të madh dhe e lusin Allahun t'ua forcojë besimin e tyre e t'ua rrisë diturinë e punët e tyre.²³ E lusim Allahun të na shtojë diturinë, bindjen, prehjen me përmendjen e Tij dhe besimin e vërtetë.

Njerëzit e mirë gjithashtu përpiqen dhe bëjnë gara me njëri-tjetrin që pas besimit në Allahun dhe në botën e fshehtë²⁴ të arrijnë bindje sikur ta kishin parë Atë me sy (ajnuljekin), pas bindjes që e kanë arritur me dije dhe teorikisht (ilmul jekin), dhe te arrijnë bindje më të plotë, sikur të kishin kontakt të drejtpërdrejtë me të (hakku ljekin).²⁵

Allahu i Madhërishëm tregon për Ibrahimin, paqja e Allahut qoftë mbi të, se ka kërkuar të arrijë një bindje më të plotë nga Allahu:

²³ Muadhi i thoshte dikujt nga vëllezërit e tij: “Ulu me ne e të besojmë një çast!”. Pastaj uleshin që të dy dhe e përkuajtonin Allahun dhe e lavdëronin Atë. (E shënon Ibn Ebi Shejbe në librin “El-Iman” (fq. 20) me zinxhir transmetuesish: të vërtetë. sipas kritereve të Buhariut dhe Muslimit e transmeton El-Esved ibn Hilal).

²⁴ Bota e fshehtë ose siç thuhet në arabishte el gajb është ajo botë të cilën ne nuk jemi në gjendje ta perceptojmë me shqisa, por që e besojmë në bazë të njohurisë që na ka ardhur nga të dërguarit e Zotit dhe në bazë të disa dëshmimeve të tjera. (sh.p.)

²⁵ *Ilmul jekin* arrihet me dije, me informim, krahasim dhe teorikisht. Ajnul jekin arrihet me pamje të drejtëpërdrejtë me sy. *Hakul jekin* arrihet me kontakt të drejtëpërdrejtë, me shijim dhe perceptim.

E para për shembull, sikurse kur dikujt i vjen lajmi se në një vend të caktuar ka mjaltë e ky e beson këtë lajm, ose sikurse kur i sheh gjurmët e mjaltit e ky e argumenton praninë e mjaltit;

E dyta: sikurse kur e sheh me sytë e vet mjaltin;

E treta: sikurse kur e shijon ëmbëlsinë e tij. Shih në “Mexhmu’ul-fetava” (10/645-652) të Ibn Tejmijes.

“Kujto edhe Ibrahimin kur ai tha: Zoti im! Më shfaq mua se si Ti i ngjall të vdekurit! Allahu iu përgjigj: A nuk beson? Ibrahim i tha: Po, besoj por dua të më qetësohet zemra (e të kem besim të fortë). Allahu i tha: Zgjidh katër zogj, pastaj ndilli drejt teje (pastaj theri ata) dhe vendosi copa-copa në çdo kodër, e pastaj thirru atyre dhe ata do të lëshohen me shpejtësi drejt teje. Dhe dije se Allahu është i Gjithëfuqishëm, më i Urti Gjithë-gjykues!” (El-Bekareh, 260)

“Kështu Ne i treguam Ibrahimit mbretërinë e qiejve dhe të tokës, që ai të ishte prej atyre që kanë besim të vendosur.” (El-En’am, 25)

Edhe havarijunët (apostujt), miqtë e ngushtë dhe pasuesit e Mesihut birit të Merjemes, kur kërkuan t’u zbresë tryeza që t’u shtohet edhe më bindja - e Isait i erdhi rëndë kjo gjë - thanë:

“Ata thanë: Ne duam të hamë prej saj dhe që të jemi më të fortë në besim, dhe ta dimë që ti me të vërtetë na ke njohur me të vërtetën dhe që vetë ne të jemi dëshmuesit e saj.” (El Maide, 113)

Ata e përmendën, pra nevojën e tyre fizike si dhe nevojën e diturisë dhe të besimit që kanë për zbritjen e asaj tryeze.

KAPITULLI I DYTË

GJËRAT NË TË CILAT BAZOHET IMANI (BESIMI)

Ky kapitull ka dobi dhe rëndësi të madhe dhe është e domosdoshme të njihet dhe të punohet sipas tij, ngase imani është përsosuri e njeriut, me të ai ngrihet në këtë botë dhe në botën e ardhshme dhe ai është shkak dhe rrugë drejt çdo të mire në të dy botët. Imani nuk arrihet e as nuk forcohet ndryshe veçse me njohjen e atyre gjërave në të cilat mbështetet, prej të cilave buron, si dhe me njohjen e shkaqeve të tij dhe rrugëve që shpiejnë nga ai. Allahu i Lartë për çdo qëllim dhe kërkesë ka bërë shkak (sebepe) dhe rrugë që çon nga ai qëllim ose ajo kërkesë. Ndërsa imani është kërkesa më e madhe dhe më e rëndësishme. Allahu ka bërë shumë gjëra me të cilat arrihet dhe forcohet ai, por në anën tjetër ka edhe shumë shkaqe (sebepe) që e dobësojnë dhe e zbehin atë.

Gjërat me të cilat arrihet imani dhe me të cilat forcohet mund t'i ndajmë në dy lloje: a) të përgjithshme dhe b) të veçanta.

a) Të përgjithshmet janë:

1. Meditimi rreth ajeteve të Allahut, të lexuara në Librin e Tij dhe në Sunnetin e të Dërguarit të Tij;
2. Meditimi për gjithësinë dhe krijesat në të;
3. Kujdesi për njohjen e së vërtetës për shkak të së cilës u krijua njeriu;
4. Të punuarit sipas kësaj të vërtete dhe në pajtim me

të.



b) Të veçantat.

Imani arrihet dhe forcohet me shumë gjëra. Prej tyre, bile më kryesorja është:

1. Njohja e emrave të bukur të Allahut, të cilët janë të shënuara në Librin e Tij (Kur'an) dhe në Sunnetin e të Dërguarit të Tij, kuptimi i atyre emrave dhe adhurimi i Allahut me to.

Buhariu dhe Muslimi përcjellin hadithin nga Ebu Hurejra, që Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë:

“Vërtet, Allahu i ka nëntëdhjetë e nëntë emra, njëqind pa një. Kush i përthekon ose i mëson ato hyn në xhennet.”

Do të thotë se kush i mëson ata emra, e di kuptimin e tyre, beson në to dhe e adhuron Allahun me to, do të hyjë në xhennet. Është e vërtetuar në Kur'an se në xhennet nuk hyn askush pos besimtarëve.

Së këndejmi përfundojmë se burimi më i madh i imanit (besimit), i fuqisë dhe qëndrueshmërisë së tij është mësimi i emrave të Allahut dhe kuptimet që i kanë ata emra, siç u cek më lart. Njohja e emrave të bukur të Allahut është themeli i imanit.

Njohja e emrave të Allahut përmban në vete tri llojet e teuhidit (të qenët e Allahut Një):

- teuhidin rububijje (veçimi i Allahut me krijim dhe sundim të gjithësisë);
- teuhidin uluhijje (veçimi i Allahut me adhurim); dhe
- teuhidin el-esmau ues-sifat (veçimin e Allahut me emrat më të bukur dhe cilësitë më të larta).

Këto lloje të teuhidit paraqesin shpirtin dhe brumin e imanit dhe njëherazi edhe synimin e tij. Rrjedhimisht, varësisht se sa i shtohet njeriut dituria për emrat e Zotit dhe

cilësitë e Tij, atij aq i shtohet imani dhe i forcohet bindja e tij. Prandaj besimtari duhet të përpiqet sa të ketë mundësi t'i mësojë emrat dhe cilësitë e Allahut. Njohja e emrave dhe cilësive në fjalë nuk duhet të prishet dhe të kalbet me sëmundjen e mohimit të ndonjërës nga ato cilësi (tatilit) dhe barazimit të atyre cilësive të Allahut me cilësitë e krijesave të Tij (temthilit). Me këto sëmundje u sëmurën shumica e atyre që vepruan në kundërshtim me udhëzimin e të Dërguarit Muhammed, paqja e Allahut qoftë mbi të. Kjo njohje duhet të themelohet mbi bazat e

Kur'anit, Sunnetit dhe kuptimeve të sahabëve (shokëve) të Pejgamberit dhe pasuesve të tyre në të mirë (tabiinëve). Pikërisht kjo është ajo njohuri e dobishme e cila njeriut ia shton besimin (imanin), ia forcon bindjen (jekin) dhe i siguron jetë të mirë.

2. Përsiatja rreth Kur'anit.

Ai që mediton për dituritë e Kur'anit i shtohet kështu imani i tij, siç thotë Allahu në Kur'an:

“...dhe kur u lexohen vargjet e Tij (Kur'ani), ato ua shtojnë edhe më besimin; dhe ata i mbështeten vetëm Zotit të tyre.” (El Enfal, 2)

Kur të shikojë njeriu sistemin, rregullin, ligjet e Kur'anit, kur të shohë se si disa pjesë të tij po i vërtetojnë të tjerat dhe po pajtohen mes vete, nuk janë kundërthënëse, dhe se asgjë aty nuk ka të kotë e të pavërtetë, se po të ishte nga dikush tjetër pos nga Allahu në të do të gjendeshin plot kundërthënie, ai bindet se ai është zbritje e të Mençurit dhe të Lavdishmit. Allahu thotë:

“A nuk mendojnë thellë për Kur’anin? Po të kishte qenë ai prej dikuj tjetër e jo prej Allahut, sigurisht që do të kishin gjetur në të mjaft kundërthënie e mospërputhje.”

(En-Nisa, 82)

Kjo gjë është nga veprimet të cilat më së shumti e forcojnë imanin, dhe atë nga shumë aspekte. Besimtari nëse vetëm e lexon Kur’anin dhe gjen aty lajme të vërteta dhe ligje të urta, atij dukshëm i përmirësohet besimi. E çka të themi për atë që mediton rreth tij dhe i kupton qëllimet dhe fshehtësitë e tij?!..., Mu për këtë besimtarët me besim të plotë thoshin:

“Zoti ynë! Vërtet ne e kemi dëgjuar thirrjen e një ftuesi (të Muhammedit) që thërret në besim: ‘Besoni në Zotin tuaj!’ dhe ne kemi besuar.” (Ali Imran, 193)

3. Njohja e haditheve të Pejgamberit Muhammed, paqja e Allahut qoftë mbi të, ngase hadithet e tij udhëzojnë në dituritë e imanit, të cilat gjithsesi janë mjete me anë të të cilave formohet imani dhe forcohet ai.

Sa më shumë që njeriu i shton njohuritë e tij për Librin e Allahut dhe Sunnetin e të Dërguarit të Tij, aq më shumë i shtohet atij besimi dhe bindja e tij. Kështu ai me këtë dituri dhe besim mund ta arrijë shkallën e bindjes së plotë. Allahu i ka cilësuar ata që janë plotësisht të vendosur në dije (err-rasihune fil ilm) si njerëz që kanë arritur dituri të plotë dhe të fuqishme, dituri që largon dyshimet dhe që zhvillon një bindje të plotë. Prandaj, këta besimtarë janë ata të cilët Allahu i ka marrë dëshmitarë për të dëshmuar para atyre që janë të luhatshëm në besim dhe para jobesimtarëve.

“(Allahu) është Ai i cili të ka zbritur ty (o Muhammed) Librin (Kur’anin). Në të ka vargje plotësisht të qarta të cilat janë themelet e Librit dhe të tjera jo krejt të qarta (për t’u kuptuar nga njerëzit). Kështu, sa për ata, në zemrat e të cilëve ka largim nga e vërteta, ata ndjekin atë që nuk është plotësisht e qartë, në këtë mënyrë duke kërkuar fitneh (mosbesim, sprovime, trazira, fatkeqësi etj.) dhe duke kërkuar për kuptimet e fshehta, por askush nuk i di kuptimet e fshehta përveç Allahut. Dhe ata që janë plotësisht të vendosur në dije thonë: ‘Ne besojmë në të, i tëri (ajete të qarta e të paqarta) është nga Zoti ynë.’ Dhe nuk marrin mësim, veçse ata që janë të brumosur me mendje të shëndoshë.” (Ali Imran, 7)

Të vendosurit plotësisht në dije janë ata tek të cilët nuk qëndron injoranca dhe llojet e dyshimeve dhe të cilët ajetet jo plotësisht të qarta (muteshabih) i barazuan me ato plotësisht të qarta (muhkemin), e thanë: Besuam në të gjitha. Të gjitha ato janë nga Allahu. Çfarë flet dhe gjykon Allahu ajo është e vërtetë dhe korrekte. Allahu thotë:

“Por ata nga mesi juaj, të cilët janë të mbështetur fort në dije dhe besimtarët, besojnë në atë që të është zbritur ty (Muhammed) dhe çfarë është zbritur para teje.” (En-Nisa, 162)

Dhe thotë Allahu:

“Allahu dëshmon se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Atij, (dëshmojnë) edhe melaiKET, edhe ata që kanë mend e që dinë (e dëshmojnë këtë); Ai e mban krjimin e Tij në drejtësi të plotë. Askush nuk ka të drejtë,

nuk meriton, e nuk duhet të adhurohet përveç Atij, i Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues.” (Ali Imran, 18)

Dhe për shkak se ata kanë pasur njohuri të plotë dhe besim të drejtë, Allahu i ka marrë si dëshmitarë në këtë botë dhe në botën e ardhme.²⁶

²⁶ Në marrjen e dijetarëve për të dëshmuar dëshminë më të madhe, e që është të qenët e Allahut një dhe i vetëm ose teuhidin e Allahut vërehet vlera e dijes dhe e dijetarëve nga disa anë:

1. Nga njerëzit e tjerë janë veçuar për të dëshmuar;
2. Allahu e ka barazuar dëshminë e tyre me dëshminë e Tij;
3. Allahu e ka barazuar dëshminë e tyre me atë të melaqeve;
4. Kjo nënkupton garancë për fenë, besimin dhe sinqeritetin e tyre, ngase Allahu nuk merr për dëshmitarë veç atyre që kanë fe dhe besim të drejtë dhe që janë të sinqertë;
5. Allahu i ka cilësuar ata si të dijshtëm. Kjo tregon se ata shquhen me dituri dhe janë bartës të saj, e nuk janë huazues të saj;
6. Allahu së pari ka dëshmuar me veten e Tij, e Ai është dëshmuesi më i madh, pastaj ka dëshmuar me dëshminë e krijesave të Tij të zgjedhura, melaqet dhe dijetarët. Mjafton ky nder dhe pozitë për ta;
7. Allahu i ka marrë ata për dëshmitarë për të dëshmuar dëshminë më të madhe, e ajo është dëshmia se nuk ka të adhuroar përveç Allahut, apo la ilahe il-lallah. Ai që ka pozitë të madhe i merr për të dëshmuar për diçka të madhe vetëm të mëdhenjtë dhe të dalluarit nga krijesat e tij;
8. Allahu e ka bërë dëshminë e tyre argument kundër atyre të cilet mohojnë besimin, prandaj ata janë si shenja dhe dëshmi që argumentojnë të qenët e Tij Një, Zot i vertetë;
9. Allahu foljen “dëshmoi”, ose në arabisht “shehide” e ka lidhur me veten e Tij, me melaqet dhe me dijetarët pa e përsëritur foljen. Kjo dëfton lidhshmërinë e ngushtë të dëshmisë së dijetarëve me atë të Allahut. Kjo kuptohet sikur Allahu dëshmoi të qenët e Tij Një Zot përmes gjuhës së tyre. Prandaj Allahu dëshmon njëshmërinë e tij, e ata (melaqet dhe dijetarët) e pranojnë dhe e besojnë këtë dëshmi.
10. Allahu i ka bërë ata të cilët do t’ua përcjellin dëshminë njerëzve se vetëm Allahu është Ai i cili meriton të adhurohet (dëshminë la ilahe il-lallah). Atë dëshmi njerëzit janë të detyruar ta pranojnë. Kjo është lumturia më e madhe e tyre në këtë botë dhe në botën e ardhme, ngase kushdo që e pranon këtë

Allahu në Kur'an thotë:

“Ndërsa ata të cilëve u qe dhënë dija e besimi do të thonë: ‘Ju me të vërtetë qëndruat sipas urdhrit (Librit) të Allahut deri në Ditën e ringjalljes, kështu pra, kjo është Dita e ringjalljes, por ju qetë që nuk e dinit.’” (Err-Rrum, 56)

Në shumë ajete Allahu tregon se Kur'ani është argument (ajet) për besimtarët dhe për të bindurit, sepse ata me besimin dhe meditimin për të fitojnë dije, besim dhe bindje, varësisht se sa Allahu u mundëson këtë. Kështu, dija, besimi dhe bindja e tyre vazhdimisht është në rritje. Prandaj meditimi për Kur'anin është nga mënyrat më të mira për themelimin e besimit (imanit) dhe për forcimin e tij. Allahu thotë:

“(Ky është) Një Libër (Kur'ani) gjithë bekime e mirësi të cilin Ne ta kemi zbritur ty me qëllim që ata të mendojnë e të thellohen në Vargjet e tij dhe që njerëzit e brumosur me mendje të shëndoshë të mund të përkujtojnë.” (Sad, 29)

Pra, rruga e përfitimit nga bereqeti i Kur'anit, e që më e madhja është arritja e besimit (imanit), është të meditohet për vargjet e tij. Po ashtu, nga ajeti i sipërpërmendur kuptohet se meditimi për Kur'anin e pengon jobesimtarin ta mohojë atë (Kur'anin) dhe nuk e lë njeriun të largohet nga Feja e Zotit. Allahu thotë:

dëshmi nga ata dhe Allahu i udhëzon, ata (dijetarët) do të kenë shpërblimin sa të atyre që e pranojnë atë. Kjo është dhunti vlerën e së cilës vetëm Allahu e di. Po ashtu, kushdo që e dëshmon këtë dëshmi që e kanë mësuar prej të diturve ata (të diturit) do të kenë shpërbëlim sa të tyre. (Miftah daris-seadeh, 1/219-221)

“A nuk e bluajnë në mendje Fjalën (e Allahut që i ka zbritur të dërguarit Muhammed)?...” (El Mu’minun, 68)

D.m.th. sikuar ata të kishin medituuar mirë për Kur’anin, nuk do të kishin mohuar dhe nuk do të kishin përgënjeshtruar, pra kjo do t’i kishte shtyrë ata të besojnë dhe ta pasojnë atë të cilit i është zbritur ai (Kur’ani). Allahu thotë:

“Përkundrazi, ata e mohojnë (atë) dijen e të cilit ata nuk mund të kapin dhe shpjegimet e të cilit akoma nuk kanë mbërritur tek ata.” (Junus, 39)

D.m.th. sikur të arrinin ta kuptoni Kur’anin nuk do ta mohonin atë, por kjo do t’i shtyente të besojnë në të.

4. Njohja e të dërguarit të Zotit, Muhammedit, e moralit të tij të mirë dhe e virtyeteve të tij të përsosura.

Kushdo që e njeh mirë Pejgamberin Muhammed, paqja e All-llahut qoftë mbi të, nuk do të ketë mëdyshje në besimin se Feja dhe Libri të cilat i ka përcjellë ai janë të vërteta. Siç thotë Allahu në Kur’an:

“Apo mos është se ata nuk e njohën të dërguarin e tyre (Muhammedin), kështu që e mohojnë atë?” (El Mu’minun, 69)

Pra, njohja e Pejgamberit e shtyn njeriun të besojë në atë që Pejgamberi beson dhe e shton besimin në atë.

Allahu i nxit kurejshitet²⁷ të mendojnë për të Dërguarin i cili i thërret ata të besojnë:

²⁷ Kurejsh quhet flsi të cilit i përkiste i Dërguari i Allahut, Muhammedi, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të.

“Thuaju (atyre, o Muhammed): ‘Unë ju bëj thirrje juve vetëm te një gjë: që ju të qëndroni për hir të Allahut në palë ose vetëm, - dhe të mendoni thellë (në veten tuaj jetën e të Dërguarit); nuk është aspak i çmendur shoku juaj (Muhammedi). Ai është vetëm këshillues juaji para një ndëshkimi të rreptë.” (Sebe, 46)

Allahu betohet në përsosurinë e këtij Pejgamberi, në moralin e tij të lartë:

“Nun. Për lapsin dhe për atë që shkruajnë (melaiket në Librin e punëve të njerëzve)! Ti (Muhammed) nga dashamirësia e Zotit tënd, nuk je i marrë. Dhe vërtet për ty do të ketë shpërbëlim të pafund. Dhe vërtet ti je në një shkallë të lartë karakteri (shpirtëror).” (El Kalem, 1-4)

I dërguari i Allahut, Muhammedi, me virtytet, sjelljet, fjalët dhe veprat e tij është motivi më i madh për besim. Ai është prijësi më i madh dhe shembulli më i përsosur për ta pasuar.

“Tashmë pa dyshim që tek i Dërguari i Allahut (Muhammedi) ju keni një shembull mjaft të mirë.” (El Ahzab, 21),

“Dhe çfarëdo që t’ju japë juve i Dërguari (Muhammedi) merreni atë dhe çfarëdo që ai jua ndalon juve hiqni dorë (prej saj).” (El Hashr, 7)

Allahu tregon se të mençurit (ulul-elbab), të cilët janë njerëzit më me vlerë, thonë:

‘Zoti ynë! Vërtet ne kemi dëgjuar thirrjen e një ftuesi - ky thirrës është pejgamberi Muhammed për të cilin po flasim - i cili thërret në besim, me fjalë, moral, dituri dhe me të gjitha

veprat e tij, dhe ne besuam bindshëm pa u luhatur. E pasi që ky besim është nga gjërat që me së tepërmi e afrojnë njeriun tek Allahu dhe nga gjërat që më së tepërmi i do Allahu, atëherë besimtarët kërkuan nga Allahu që për shkak të këtij besimi t'ua falë dhe t'ua mbulojë mëkatet dhe kërkuan nga Ai pozita të larta.

“Zoti ynë! Vërtet ne e kemi dëgjuar thirrjen e një ftuesi (të Muhammedit) që thërret në besim: ‘Besoni në Zotin tuaj’ dhe ne kemi besuar. Zoti ynë! Na i fal neve gjynahet tona, dhe na i hiq nga barra jonë veprat tona të ulëta dhe na bëj që të mund të vdesim duke qenë në të drejtën së bashku me besimtarët e vërtetë e të drejtë.” (Ali Imran, 193)

Prandaj një njeri që nuk kishte për qëllim tjetër gjë veç njohjen e së vërtetës, posa shihte Pejgamberin dhe dëgjonte fjalën e tij, menjëherë besonte në të dhe nuk mbetej asnjë fije dyshimi në misionin e tij. Bile shumë prej tyre posa e shihnin fytyrën tij të ndritur e kuptonin se ajo nuk është fytyrë rrenacaku. Dikujt i është thënë:

Pse nxitove të besosh në Muhammedin? Është përgjigjur: Në çdo gjë që ai ka urdhëruar për të bërë, mendja ka thënë: Sikur të urdhëronte në të! Dhe në çdo gjë që ka ndaluar, mendja ka thënë: Sikur të ndalonte nga ajo! Ky njeri i mençur argumentoi vërtetësinë e misionit të Pejgamberit si ligj i mirë që pajtohet me logjikën e shëndoshë, dhe pastaj nxitoi në besim.

Për këtë mbreti romak, Herakliu, pasi që kuptoi se me çfarë ka ardhur Pejgamberi, çfarë urdhëron ai dhe çfarë ndalon ai, argumentoi me këto se ai është më i madhi peygamber dhe

këtë gjë e pranoi pa kurrfarë dyshimi.²⁸ Mirëpo pozita e tij dhe frika se po e humb sundimin e pengoi atë ta pasojë të Dërguarin, ashtu siç i pengoi po kjo gjë shumë të tillë që e kuptuan se ai është i dërguar i vërtetë nga Zoti.

²⁸ Hadithi i Herakliut është mbledhur në dy Sahihët (Sahihu i Buhariut (7) dhe ai i Muslimit(1773 dhe 73). Përcillet nga Ibën Abbasi të ketë thënë: Pasi që Herakliu u foli delegacionit kurejshit, në të cilin ishte edhe Ebu Sufjani, para se të pranonte Islamin, ndër të tjera Herakliu i tha përkthyesit: Thuaji atij (Ebu Sufjanit): Të pyeta për prejardhjen e tij. Ti më tregove se ai është nga një fis me nam në mesin tuaj. Kështu pejgamberët dërgohen nga fliset me nam në popull. Të pyeta : A ka thënë dikush nga ju këtë fjalë? (D.m.th. se është i dërguar nga Zoti.) Më the se jo, Mendova: sikur të thoshte dikush para tij këtë, do të thosha se është njeri që po e imiton dikë tjetër.

Të pyeta: A ka qenë ndonjëri nga baballarët e tij mbret? Më the se jo. Mendova: sikur të kishte pasur ndonjë nga paraardhësit e tij mbret, do të thosha se është njeri që kërkon ta kthejë mbretërinë e baballarëve të tij.

Te pyeta: A e keni akuzuar për gënjeshtëri para se të thotë atë që e tha? Më tregove se jo. Kuptova se ai nuk do ta linte gënjeshtërinë në emër të njerëzve e të gënjente në emër të Zotit.

Të pyeta: Njerëzit e derës së lartë e pasojnë, apo të dobëtit? Më the se të dobëtit nga populli e pasojnë. Mu ata janë pasuesit e pejgamberëve.

Të pyeta: A po shtohen ata apo po pakësohen? The se po shtohen. Kështu ndodh me besimin , derisa të plotësohet.

Të pyeta: A e braktisë ndonjëri nga ata atë Fe pasi që hyn në të, për shkak se është zemëruar në atë Fe? Më the se jo. Kështu është besimi, kur ëmbëlsia e tij futet në zemra.

Të pyeta: A mashtron? The se jo. Po kështu. profetët nuk mashtrojnë.

Të pyeta: Çka ju urdhëron? Përmende se ju urdhëron vetëm e vetëm Allahun ta adhuron, e mos ta shoqëroni dikë tjetër në adhurim; ju ndalon të adhuronit idhujt dhe ju urdhëron të falni namazin, të jeni të singertë dhe të vetëpërmabajtur. Nëse është e vërtetë ajo që thua, atëherë ai do ta sundojë vendin e këtyre këmbëve të mia. E kam ditur se ai do të paraqitet diku, por nuk mendoja se do të dalë nga ju. Sikur ta dija se do të kisha arritur tek ai do të kisha vuajtur për takimin me të dhe sikur të isha atje tek ai do të ia laja këmbët

e tij...

Kjo është njëra nga gjërat që më së tepërmi i pengon këta njerëz të besojnë.²⁹³⁰

Por, njerëzit e urtë nuk i pengon pozita udhëheqëse, e as dyshimet dhe epshet të cilat një ditë do të vyshken, ata nuk i shtyejnë këto gjëra të refuzojnë të vërtetën e cila jep fryt të mirë në këtë botë dhe në botën e ardhme.

Për këtë arsye, ata te cilët interesohen për ta studiuar dhe memorizuar Kur'anin dhe hadihtet³¹ e vërteta janë njerëz me besim dhe bindje më të plotë se të tjerët, dhe shpeshherë me vepra më të mira.

5. Përsiatja për gjithësinë.

Krijimi i qiejve, i tokës dhe i krijesave që gjenden në to, posaçërisht qenia e njeriut janë motiv i fuqishëm për besim, ngase në këtë krijimtari të madhe pasqyrohet fuqia dhe madhështia e Krijuesit. Në sistemin dhe në bukurinë e saj, e cila i mahnit njerëzit e mençur, shihet gjerësia dhe thellësia e dijes së Allahut dhe mençuria absolute e Tij.

Të mirat dhe dobitë e pakufizuara që dëshmojnë mëshirën, ekzistencën dhe bamirësinë e Allahut, të gjitha këto nxisin të madhërohet Krijuesi dhe Shpikësi i tyre, të falënderohet Ai, të përmendet dhe të adhurohet vetëm Ai. Ky është shpirti i besimit (imanit) dhe fshehtësia e tij.

²⁹ Me shprehjen “të besojnë” autori këtu e ka për qëllim kuptimin terminologjik të kësaj shprehje që sipas Sheriatit besim (iman) do të thotë besim me zemër, deklarim i këtij besimi me gjuhë dhe veprim me gjymtyrë i asaj që e kërkon ky besim, ashtu siç u shpjegua në fillim të këtij libri. (sh.p.)

³⁰ Autori ka një libër që flet për gjërat më parimore dhe me të rëndësishme të Fesë dhe gjërat e që pengojnë njeriun të besojnë.

³¹ Hadith quhen fjalët, veprimet, miratimet dhe cilësitë e Pejgamberit Muhammed, paqja e Allahut qoftë mbi të.

Po kështu, edhe përsiatja për varfërinë e gjithë krijesave, për nevojën e madhe që kanë ato për Zotin e tyre dhe për faktin se ato nuk mund të qëndrojnë pa Zotin e tyre as vetëm për një çast, veçanërisht për nevojën që e vëren njeriu në vete për Zotin, krejt këto robin e Zotit e shtyejnë që plotësisht t'i nënshtrohet Atij dhe ta lusë Atë me përkushtim për gjërat e dobishme për Fenë dhe mirëqenien e tij në këtë botë dhe për të larguar nga ai gjërat që dëmtojnë fenë dhe mirëqenien e tij në këtë botë, e shtyejnë atë të mbështetet krejtësisht në Zotin e tij, të jetë plotësisht i bindur në premtimin e Tij dhe të dëshirojë shumë bamirësinë e Tij. Në këtë mënyrë jetësohet besimi dhe forcohet adhurimi, ngase lutja është thelbi i adhurimit.

6. Përsiatja për mirësitë e Allahut.

Këto të mira janë për të gjithë dhe çdo krijesë e Zotit i shfrytëzon ato në çdo moment pandërprerë. Meditimi për këtë udhëzon në besim. Zoti e ka thirrë të Dërguarin dhe besimtarët, që në këtë bazë, ta falënderojnë Atë:

“O ju që keni besuar (Allahun Një në besimin e pastër islam)! Hani nga gjërat e lejuara me të cilat Ne ju kemi furnizuar dhe bëhuni falënderues e mirënjohës ndaj Allahut, nëse me të vërtetë është Ai të cilin ju e adhuroni!”
(El Bekarah, 172)

Besimi, pra, thërret në falënderim, kurse falënderimi e shton besimin. Secila nga të dyjat e sjell dhe e imponon tjetrën.

7. Përkujtimi dhe përmendja e Zotit në çdo kohë, si dhe lutja drejtuar Atij, ngase lutja është brumi i adhurimit.³²

Përmendja e Zotit me lavdërim, madhërim, falënderim dhe lutje e mbjell pemën e besimit në zemër, e ushqen dhe e rrit atë. Kështu, sa më shumë që njeriu ta përmendë Allahun, aq më shumë forcohet besimi i tij.

Në të vërtetë, besimi bën që të përmendet shumë Allahu, ngase kush e do Allahun, ai e përmend shumë Atë. Kurse dashuria për Allahun është vetë besimi, shpirti i tij pra.

8. Njohja e të mirave të Fesë.

Krejt Feja islame është e mirë, besimi i saj është besimi më i vërtetë, më korrekt dhe më i dobishëm, morali i saj është morali më i lavdueshëm dhe më i miri. Po kështu, edhe veprat dhe ligjet e saj janë më të mirat dhe më të drejtat. Me këtë shikim të Fesë islame, Allahu e zbukuron besimin në zemrën e robit dhe ia bën të dashur atë. Këtë dhunti Allahu ua fali vetëm krijesave të Tij të zgjedhura.

“Por Allahu e ka futur thellë besimin te ju dhe jua ka zbukuruar atë në zemrat tuaja.” (El Huxhurat, 7)

Atëherë besimi bëhet gjëja më e dashur dhe më e bukur në zemër. Kështu, njeriu e gjen në zemrën e tij besimin dhe e shijon ëmbëlsinë e tij. Brendësia zbukurohet me themelet e besimit, ndërsa gjymtyrët zbukurohen me veprat e tij.

³² Autori, Allahu e mëshiroftë, aludon në hadithin daif (të dobët) të cilin e shënon Tirmidhiu (hadithi numër 337) me këtë shprehje: “Lutja është brumi i adhurimit (ibadetit)” Hadithi është sahih me këtë shprehje: “Lutja është vetë adhurimi.” Ky hadith përcillet nga Nu’man ibën Beshir dhe e shënon Ahmedi (4/267), Ebu Davudi (1478), Tirmidhiu (3372) Dhe Ibën Maxheh. E ka vlerësuar si sahih Hakimi (1/490, 491) dhe me këtë vlerësim pajtohet edhe Dhehebiu. Po ashtu, edhe Neveviu e vërteton në veprën e tij “El-Edhkar” (faqe 333).

Pejgamberi bënte lutje:

“O Allah, na zbukuro me stolitë e imanit dhe na bëj udhëzues e të udhëzuar!”³³³³

9. Përpjekja për të arritur shkallën e bamirësisë në adhurimin e Zotit dhe bamirësinë me krijesat e Tij.

Kjo arrihet duke u përpjekur të adhurohet Allahu sikurse ta shohim Atë. Nëse kjo nuk mund të arrihet, atëherë ndërgjegjësohemi se Allahu na sheh ne, kështu që vepra sillet më afër përsosurisë. Njeriu vazhdimisht jep mundin e tij për ta arritur këtë shkallë të lartë, ndërsa besimi dhe bindja e tij i forcohet derisa të arrijë shkallën më të lartë të bindjes (e ajo është hakkul jekiin), që pastaj të shijojë ëmbëlsinë e adhurimeve dhe t’i gëzojë frytet e punëve. Pikërisht ky është imani i plotë.

10. Mirësia ndaj krijesave, me fjalë, punë, pasuri, pozitë dhe me gjëra tjera të ndryshme.

Krejt këto janë pjesë të imanit dhe vepra të motivuara nga ai. Shpërblimi i Zotit varet nga vepra. Ashtu siç njeriu i bën mirë robërve të Allahut, aq sa ka mundësi, edhe Allahu ia kthen të mirën atij. Allahu i dhuron atij lloj-lloj të mira. E më e vlefshmja nga ato të mira është ajo se Allahu ia forcon atij besimin dhe dëshirën për të bërë mirë, për t’iu afruar Allahut dhe për t’i bërë të gjitha veprat sinqerisht për të.

Pejgamberi ka thënë: *“Nuk do të besoni, derisa t’ia doni vëllait tuaj atë që ia doni vetvetes.”* (Buhariu dhe Muslimi)³⁴

³³ Ky është hadith sahih (i vërtetë) dhe është pjesë nga hadithi të cilin e tregon Ammar ibën Jasir dhe e shënon Ahmedi (4/264), Nesaiu (3/54, 55), Hakimi e vërteton (1/524,525) dhe me të pajtohet edhe Dhehebiu.

³⁴ Shiko tahrخين fq. 29.

11. Veprat që i përmban fjala e Zotit në Kur'an:

“Vërtet që tashmë kanë fituar besimtarët. Ata të cilët në namazin e tyre janë të përlulur. Edhe ata të cilët i shmangen së kotës (fjalë a punë, rrenës, mashtrimit, përgojimit etj.). Edhe ata të cilët e japin zekatin. Edhe ata të cilët i ruajnë pjesët e tyre vetjake, përveç ndaj grave të veta dhe ndaj atyre që i kanë në pronësinë e vet (robëreshave), për të cilat nuk qortohen. Po kush kërkon përtej kësaj, të tillët janë ata që i kanë shkelur normat e caktuara. Edhe ata të cilët janë besnikë ndaj amanetit³⁵ të tyre dhe besës së dhënë. Edhe ata të cilët i kushtojnë kujdes faljes së namazit të tyre. Këta janë me të vërtetë trashëguesit...» (El Mu'minun, 1-10)

Secila nga këto pesë virtyte e lindin besimin dhe e zhvillojnë atë, dhe në të njëjtën kohë që të gjitha ato bëjnë pjesë në përkufizimin e imanit, siç u shpjegua.

T'i vështrojmë në vazhdim secilën veç e veç:

- Prezenca e zemrës në faljen e namazit, përpjekja e falësit të përqendrohet në atë që thotë dhe bën në namazin e tij, përqendrimi në lexim të Kur'anit, në lutje, në madhërim të Zotit, në qëndrim në këmbë, në përkulje, në sexhde etj., të gjitha këto janë shkaqe që shtojnë dhe zhvillojnë imanin.

Më heret u cek se Allahu në Kur'an e ka quajtur namazin iman (besim):

“Allahu kurrë nuk do t’jua humbasë imanin (besimin) tuaj.” (El Bekarah, 143)

³⁵ Amanetet: Detyrimet ndaj Allahut. ndershmëria, besimi, përgjegjësia morale.

Dhe thotë:

“Fale namazin! Vertet që falja e namazit parandalon nga çdo vepër e papëlqyer, e ulët, e keqe dhe nga çdo vepër e padrejtë (mosbesim, politeizëm dhe gjynahe të tjera), dhe përkujtimi i Allahut është gjëja më madhështore.”
(El Ankebut, 45)

Namazi, pra, është pengesa më e madhe që ndalon nga çdo e keqe dhe e shëmtuar që është në kundërshtim me besimin. E ai përmban edhe përmendjen e Allahut, gjë e cila e ushqen dhe e rrit imanin, siç thotë Allahu:

“Përkujtimi i Allahut është gjëja më madhështore.” (El Ankebutë, 45)

- Lëmosha, qoftë ajo e detyrueshme (zekati) a vullnetare (sadaka), po ashtu e rrit dhe e shton imanin. Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Dhënia e lëmoshës është dëshmi.”³⁶ Pra, dëshmi për besimin (imanin) e atij që e jep. Ajo është tregues për ekzistencën e besimit në zemër të njeriut, e ushqen dhe e rrit atë besim.

- Braktisja e së kotës, që është çdo fjalë e punë e padobishme.

Por, besimtarët flasin fjalë të mira e të dobishme dhe punojnë punë të mira e të dobishme, dhe braktisin çdo fjalë dhe punë të keqe dhe të padobishme.

³⁶ Kjo është pjesë nga hadithi të cilin e shënon Muslimi (1/223) nga Ebu Malik el-Esh’arij. Në hadith është përmendur shprehja burhan (të cilin e përktheva si dëshmi -sh.p.) që emërton rrezet e diellit që shihen përreth diskut të tij. Pastaj, kjo shprehje është përdorur për të treguar dëshminë e prerë që tregon argument të qartë për diçka të caktuar. Po kështu, lëmosha është dëshmi e qartë, burhan, për ekzistencën dhe dëlirësinë e besimit dhe për shpirtmirësinë e atij që e jep atë. Cituar nga Xhamiul Ulumi vel Hikemi (2/23)

S’do mend se ky virtyt është pjesë e imanit, që nëse ekziston në të, imani është më i plotë, e nëse mungon, atëherë imani është më i mangët.

Sahabët, Zoti qoftë i kënaqur me ta, kur vërenin në vete shkujdesje ndaj ligjeve të Fesë dhe dobësim të besimit, i thoshin njëri-tjetrit “Të ulemi të besojmë një çast!”,³⁷ dhe e përmendnin Allahun dhe dhuntitë e Tij në fe dhe në dynja. Në këtë mënyrë ata e ripërtërinin besimin e tyre.

- Vetëpërmbytja nga të këqijat, e veçanërisht nga zinaja.³⁸ Padyshim se kjo është ndër shenjat më të mëdha të besimit, si dhe ndër gjërat që më së tepërmi e rrisin atë. Besimtari, për shkak të frikës që e ka kur kujton se do të qëndrojë para Zotit të vet, vetëpërmbahet nga epshi. Kështu, ai i përgjigjet thirrjes së besimit dhe e ushqen atë.

- Ruajtja e amaneteve³⁹ dhe përmbushja e premtimeve. Edhe ky virtyt është shenjë e besimit te besimtari. Në një hadith thuhet: “Nuk ka besim ai që nuk e ruan amanetin.”⁴⁰

Në qoftë se dëshiron ta dish besimin dhe fenë e një njeriu, shiko se a i ruan amanetet që i janë lënë atij, a i kryen detyrimet, marrëveshjet dhe premtimet ndaj Zotit dhe njerëzve. Nëse po, atëherë ai është fetar dhe besimtar i mirë.

³⁷ Shih tahrixhin fq 41.

³⁸ Zina d.m.th. marrëdhënie seksuale me gruan, respektivisht burrin joligjor.

³⁹ Fjala amanet është me origjinë nga gjuha arabe dhe kur të përdoret në tekstet e Islamit (Kur’an dhe Hadith) emërton obligimet dhe detyrat e njeriut që i janë lënë nga Zoti dhe njerëzit.

⁴⁰ Hadith i vërtetë. E shënon Ahmedi (3/135, 154, 210, 251), Ibën Hibban (47), Begavijj në “Sherhus-Sunneh” (1/75), Bejhekijj (6/288) dhe Ibën Ebi Shejbeh në “El Iman” (7) nga Enesi, nga Pejgamberi me këtë shtesë: “...dhe nuk ka fe ai që nuk e përmbush premtimin e tij.” Albani e vlerëson si hadith sahih në tahrixhin e “El Iman” të Ibën Ebi Shejbeh (7).

E nëse jo, atëherë feja dhe besimi i tij është i mangët, varësisht se sa ka mangësi në çështjet për të cilat bëhet fjalë.

Në fund përmendet kujdesi për namazin, që ka për qëllim të plotësohet ai me të gjitha pjesët e tij, dhe kujdesja për kohën e duhur të çdo namazi. Kujdesja për namazin është sikur uji që rrjedh nëpër kopshtin e besimit, e ujit dhe e rrit atë, që ajo më pastaj t'i çelë frytet e saj në çdo kohë. Më parë u tha se pema e besimit ka nevojë në çdo kohë për ujë që të ripërtërihet dhe ka nevojë për t'u pastruar toka e saj nga gurët, bari i keq dhe therrat që mbijnë rreth saj. E ai ujë për të janë adhurimet dhe veprat e mira, ndërsa ai bar dhe ato therra të dëmshme janë fjalët dhe veprat e ndaluara. Kur të bëhet kjo, ai kopsht ngjallet dhe lulëzon dhe jep turli fryta.

12. Të ftuarit në Rrugë të Allahut, porositja për t'iu përmbajtur së vërtetës dhe për të bërë durim në këtë rrugë, thirrja në parimet e Fesë dhe për të zbatuar ligjet e saj. Me këtë njeriu përmirësohet vetë dhe i përmirëson të tjerët.

Allahu është betuar në kohën se njerëzit janë në humbje, me përjashtim të atyre që cilësohen me këto katër karakteristika: me besim, me punë të mira - me të cilat përsoset shpirti - me porositje për ta ndjekur të vërtetën dhe me porositje për durim. Kjo kërkon njohje të Fesë dhe durim gjatë kryerjes së këtyre punëve. Me këto dy të fundit besimtari i përmirëson të tjerët.

Është fakt se thirrja në Rrugë të Allahut dhe këshillimi i të tjerëve e shton besimin e njeriut, sepse vetë ky veprim është një nga faktorët që më së shumti e forcojnë imanin dhe sepse ai që thërret të tjerët në atë Rrugë duhet t'i mësojë patjetër argumentet që e vërtetojnë korrektësinë e asaj Rruge në të cilën thërret.

Ai pastaj duhet të fillojë këtë rol me maturi, duke i marrë parasysh përparësitë dhe metodat më efektive për t'i arritur qëllimet, gjëra këto që llogariten si rrugë dhe dyer që shpiejnë nga imani. I tilli do të shpërblehet me atë në të cilën i thërret të tjerët. Për shkak se ka dhënë mund që t'i përmirësojë të tjerët dhe ka përballuar vështirësi të ndryshme në këtë rrugë, Allahu gjithsesi do ta shpërbëjë me ato gjëra në të cilët i ka ftuar të tjerët dhe do ta përkrahë atë me dritën e Tij dhe me fuqinë e besimit dhe të mbështetjes në Zotin (tevekkul).

Me besim dhe mbështetje në Zotin arrihet fitorja mbi armiqtë, djajtë njerëz dhe djajtë xhinde. Këtë e thotë Allahu në Kur'an:

“Vërtet ai (shejtani) nuk ka aspak fuqi mbi ata që besojnë e që mbështeten vetëm te Zoti i tyre.” (En Nahl, 99)

Dhe, gjithashtu, i tilli sfidon për të lartësuar të vërtetën, e atij që sfidon, patjetër se do t'i hapen dyert e diturisë dhe të besimit, varësisht nga sinqeriteti i tij.

Dhe për fund, nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në forcimin e imanit është:

13. Stërvitja e shpirtit që t'u bëjë ballë të gjitha atyre gjërave që janë në kundërshtim me besimin, e ato janë degët e mosbesimit (kufrit) dhe të dyfytirësisë (nifakut) dhe mëkatet.

Mu ashtu siç kërkohen disa gjëra që paraqesin shkaqe për të forcuar dhe shtuar besimin, gjithashtu kërkohet të sigurohet ai besim nga gjërat që e kundërshtojnë dhe e dobësojnë atë. Kjo arrihet duke i braktisur mëkatet dhe duke u pënuar për mëkatet e bëra, përmes ruajtjes së gjymtyrëve nga haramet, përmes luftimit të dyshimeve të cilat brejnë

dhe dobësojnë dituritë e besimit, si dhe nëpërmjet luftimit të dëshirave që e dëmtojnë dhe dobësojnë vullnetin e besimit. Vullneti që buron nga dëshira për të bërë mirë nuk mund të vijë në shprehje veçse me mohimin e vullnetit që buron nga dëshira për të bërë keq dhe me luftimin e shpirtit që nxit në sherr.

Kur të ruhet njeriu të mos bjerë në dyshime dhe epshe, besimi i tij plotësohet dhe bindja e tij forcohet. Kopshti i besimit të tij bëhet:

“...si ai kopshti në kulmin e tij bie një shi i mirë dhe ai e dyfishon prodhimin. Edhe nëse nuk i bie ndonjë shi i mirë, një shi i lehtë i mjafton. Dhe Allahu është Gjithëvëzhgues për gjithçka që ju veproni.” (El Bekarah, 265)

Në të kundërtën, në qoftëse atë e mbisundon shpirti i cili nxit në të këqija dhe bie në grackën e dyshimeve dhe epsheve, a të njërës nga ato, për të vlen shembulli që çeket në Kur’an:

“A do të dëshironte ndonjë nga ju të kishte një kopsht me hurma dhe rrush, me lumenj që rrjedhin poshtë tij dhe me gjithë llojet e frutave për të, ndërsa atë e kap mosha e thyer, ndërsa ka fëmijët të dobët (jo në gjendje të kujdesen për vete), pastaj kopshti goditet me një vorbull ere të zjarrtë dhe kështu ai digjet? Kështu Allahu jua bën të qarta ajetet (provat, treguesit, vargjet) me qëllim që mbase ju mendoni.” (El Bekarah, 266)

Prandaj, besimtari i mirë vazhdimisht përpiqet t’i arrijë dy gjëra:

E para: Parimet dhe degët e besimit. D.m.th. njohja dhe jetësimi praktik i tyre, dhe

E dyta: Largimi i faktorëve që janë në kundërshtim me imanin, që e dëmtojnë dhe e pakësojnë atë. Ato janë sprovat e dukshme dhe të fshehta, dhe ai i shëron së pari ato në të cilat tanimë ka rënë, me pendim të sigurtë, e pastaj ato të cilat i kanosen, duke i penguar që më parë. Allahu na mëson:

“Në të vërtetë ata që janë të përkushtuar e që i ruhen dënimit të Allahut kur u vjen ndonjë mendim i lig prej shejtanit, ata kujtojnë (Allahun) dhe vërtet që pas kësaj ata shohin drejt.” (El A’raf, 201)

Shohin gabimin në të cilin kanë rënë dhe dëmin që i ka goditur nga mendimi i shejtanit, i cili është armiku më i madh i njeriut. Kur e shohin atë, e pengojnë që më parë duke ia mbyllur rrugët atij. Ky është arnim i çarjes së shejtanëve. Dhe kthehen në gjendjen e përsosurisë së tyre. E armiku i tyre zbrapset i mposhtur e i poshtëruar.

Ndërsa vëllezërit e shejtanëve

“...ata (shejtanët) i zhysin gjithnjë e më thellë në të gabuarën dhe as që ndalen në këtë rrugë.” (El A’raf, 202)

Shejtani vazhdimisht i lajkaton e i kandis ata për t’i futur në shkatërrim, ndërsa ata që i përgjigjen atij vazhdimisht i binden armikut të tyre dhe u përgjigjen thirrjes së tyre, derisa t’i fusin në shkatërrim dhe ta meritojnë humbjen e plotë.

O Allah, na bëj të dashur besimin dhe zbukuroje atë në zemrat tona! Na e bëj të urrejtur neve mosbesimin (kufrin) dhe mëkatin! Na udhëzo me mëshirën dhe dhuntinë Tënde! Vërtet, Ti je i Dituri dhe i Mençuri.

KAPITULLI I TRETË

DOBITË DHE FRYTET E IMANIT (BESIMIT)

Sa e sa dobi, fryte dhe jetë të mirë jep besimi i shëndoshë në zemër dhe trup, në këtë botë dhe në të ardhmen. Sa e sa fryte të bëra e të shijshme, ushqim të përhershëm, të mira të vazhdueshme dhe të pandërprera, gjëra të panumërta dhe dobi të pafundshme ka nxjerrur pema e besimit. Në përgjithësi, të mirat e dynjasë dhe të ahiretit (botës së ardhme) dhe sigurimi nga të këqijat, të gjitha këto janë fryte të kësaj peme. Ngase kjo pemë kur të mbillet dhe t'i forcohen rrënjët e t'i hapen degët e të lulëzojnë ato dhe të piqen frytet e saj, atëherë këto të mira i bëjnë dobi poseduesit të kësaj peme, por edhe të tjerëve, në të dy botët. Ndër frytet më të mëdha të saj janë:

1. Fitimi i dashurisë së Allahut, që është qëllimi më i lartë dhe gjëja më me vlerë që mund të arrijë njeriu. Allahu i Lartë ka thënë:

“Nuk ka fare dyshim! Me të vërtetë, për të dashurit e Allahut (të përkushtuarit, besimtarët e vërtetë që i dorëzohen plotësisht Allahut) as frikë nuk do të ketë për ta, e as nuk do të pikëllohen. Të cilët besuan (në njëjësinë e Allahut, në Islam) dhe që gjithnjë e patën frikë Allahun (me përkushtim ndaj Tij duke u ndalur prej së keqes e duke vepruar të mirën).” (Junus, 62 - 63)

Rrjedhimisht çdo besimtar i përkushtuar (Allahut dhe Fesë) është i dashur i Allahut.⁴¹ Në vazhdim po përmendim edhe disa fryte të tjera të imanit:

2. Ajo të cilën e tregon fjala e All-llahut:

“Allahu është Mbrojtësi dhe Ruajtësi i atyre që e besojnë Atë. Ai që i nxjerr ata nga errësira në dritë, për sa për ata që nuk besojnë, mbështetës dhe ndihmues të tyre janë tagutët: këta i nxjerrin nga drita dhe i zhysin në errësirë.”
(El Bekarah, 257)

D.m.th. i nxjerr ata nga errësitat e mosbesimit (kufrit) në dritën e besimit (imanit), nga errësitat e paditurisë në dritën e dijes, nga errësitat e mëkateve në dritën e respektimit dhe nga errësira e shkujdesjes në dritën e zgjimit dhe kujdesit. Me një fjalë, Allahu i nxjerr ata nga errësitat e të këqijave të ndryshme, e i shpëton në dritën e të mirave të kësaj botë dhe të botës së ardhme. Ata këtë dhunti të madhe e arritën me besimin e vertetë të tyre dhe me jetësimin e këtij besimi, që bëhet me përkushtim ndaj Allahut dhe Fesë së Tij, ngase ky përkushtim është plotësim i besimit, siç u vërtetua kjo në fillim të librit.

3. Fitimi i kënaqësisë së Allahut dhe e vendbanimit të ndershëm të Tij. Allahu ka thënë:

“Besimtarët dhe besimtares janë ndihmues dhe mbrojtës e miq për njëri-tjetrin, ata thërrasin në të mirë (u mishërojnë (njerëzve) Islamit dhe gjithë përmbajtjen e tij çfarë urdhëron ai) dhe i ndalojnë nga e keqja (nga

⁴¹ Këtë e pohon Shejhul islami Ibën Tejmijje në «El Furkan bejne eulijaurrahman ve evlijaush-shejtan», fq. 57.

mosbesimi, politeizmi i çdo lloji dhe gjithçka tjetër që Islami e ndalon), **ata e kryejnë rregullisht e në mënyrë të përkryer namazin, japin zekatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata mbi të cilët Allahu do të derdhë mëshirën e Tij. Vërtet Allahu është i Gjithëfuqishëm dhe më i Urti Gjithëgjykses. Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve kopshte të begata të xhennetit nën të cilët rrjedhin lumenj për të banuar ndër ta ngaherë dhe në vilat mahnitëse në kopshtet e xhennetit të Adnit. Por lumturia më e madhe është kënaqësia e Allahut. Ky është ai, ngadhënjimi më i madh.”** (Et-Teubeh, 71 - 72)

Ata e fituan kënaqësinë e Zotiti të tyre dhe mëshirën e Tij dhe këto vendbanime të mira me besimin (imanin) e tyre, duke e përsosur veten dhe të tjerët përmes nënshtrimit Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe përmes thirrjes në punë të mira dhe ndalimit nga të këqijat. Ata zotëruan me mjetet më të mëdha dhe me qëllimet më të mëdha. Kjo, me të vërtetë, është dhuratë e madhe e Zotit.

4. Imani i plotë ndalon nga zjarri i xhehennemit, kurse imani, qoftë edhe pak, ndalon për të mos mbetur përherë në atë zjarr. Atë të cilin besimi e shtyn t’i kryejë urdhrat e Zotit dhe të largohet nga haramet nuk do të hyjë në xhehennem. Hadithet e Pejgamberit, paqja e Allahut qoftë mbi të, që vërtetojnë këtë janë të shumta dhe të vërteta (mutevatir). Të tilla janë edhe hadithet që vërtetojnë se ai që ka në zemrën e tij iman, qoftë edhe pak, nuk do të ngelë

përgjithmonë në zjarrin e xhehennemit.⁴²

5. Allahu i mbron nga të gjitha të këqijat dhe i shpëton nga vështirësitë ata që besojnë në të.

Allahu ka thënë në Kur'an:

“Pa dyshim që Allahu i mbron ata që besojnë” (El Haxh, 38)

D.m.th. ua largon atyre çdo dëm, të keqen e shejtanëve njerëz dhe shejtanëve xhinde dhe i mbron nga armiqtë. Ua largon dëmet para se t'i godasin dhe i shpëton e ua lehtëson ato pasi që t'i kenë goditur.

Pasi që Allahu e ka treguar hallin në të cilën ka rënë Junusi, paqja e Allahut qoftë mbi të, dhe se ai:

“Thirri në errësirë: Nuk ka të adhurar tjetër të merituar përveç Teje, o Allah; i Lavdueshëm dhe i Lartë je Ti përmbi çdo të keqe që të veshin ty. Vërtet që kam qenë prej zullumqarëve (La ilahe il-lla ente, subhaneke, inni kuntu minedh-dhalimin)” (El Enbija, 87)

tha (Zoti): **“Kështu Ne iu përgjigjëm thirrjes së tij dhe e çliruam atë nga fatkeqësia e kësisoj Ne i shpëtojmë besimtarët.”** (El-Enbija, 88)

⁴² Nga ato po përmendim hadithin që e shënon Buhariu (44) dhe Muslimi (193 dhe 325) të përcjellur nga Enesi, ku qëndron: “Do të dalë nga zjarri ai që thotë La ilahe il-lallah (Nuk ka të adhurar me meritë veç Allahut) dhe në zemrën e të cilit ka hajr sa një kokërr elbi dhe do të dalë nga zjarri i xhehennemit ai që thotë La ilahe il-lallah dhe në zemrën e të cilit ka sadopak hajr.” Citati është i Buhariut.

Qëllimi i tij me shprehjen “hajr” në hadith është imani, siç e ka interpretuar Ibën Haxheri në Fet-hul Barij (1/105).

I shpëton ata kur të hasin në vështirësi, ashtu siç e shpëtoi Junusin. Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë:

“Çdo besimtar që e lut Zotin me të njëjtën lutje me të cilën e ka lutur vëllai im, Junusi, Allahu do ta shpëtojë atë nga telashet e tij. Ajo lutje është: Nuk ka të adhuruar, përveç Teje. I pa të meta je Ti. Unë u bëra nga të padrejtit (zullumqarët).”⁴³

Allahu ka thënë:

“Dhe kushdo që ka frikë Allahun dhe përmbush detyrimin ndaj Tij...”

Pra, duke besuar dhe duke i zbatuar veprat të cilat i kërkon besimi

“...Ai do të sjellë rrugë për të dalë nga çdo vështirësi.”

(At-Talakë, 2) nga çdo gjë që u shkakton vështirësi njerëzve, dhe

“Dhe kushdo që ka frikë Allahun dhe përmbush detyrimin ndaj Tij, Ai do t’ia bëjë atij çështjen të lehtë.” (Et-Talak, 4)

Besimtarit të përkushtuar Allahu ia lehtëson punët dhe jetën e tij dhe ia hap rrugët e lehta dhe e shpëton nga të vështirat. Ia lehtëson vështirësitë, dhe e shpëton nga çdo brengë, në çdo vështirësi i gjen rrugëdalje dhe e furnizon nga nuk e pret. Këtë Kur’ani dhe Sunneti e dëshmojnë në shumë vende.

6. Besimi dhe vepra e mirë, e cila është degëzim i besimit siguron një jetë të mirë në këtë botë dhe në botën e amshueshme.

⁴³ Hadithi është sahih (i vërtetë). E shënon Ahmedi (1/170), Tirmidhiu (3595), Nesaiu në Amelul jevmi vel-lejl “ (656), Hakimi dhe e verifikon vërtetësinë e tij Dhehebiu, ndërsa Hafidh Ibën Haxher e konsideron si hadith hasen (të mirë) në “Emalijjul edhkar”. Shih për këtë “El futuhatë err-rabbanijjeh” (4/11).

Allahu ka thënë:

“Kushdo që punon të drejtën e të mirën, burrë a grua qoftë, duke qenë besimtar i vërtetë, sigurish që Ne do t’i dhurojmë atij jetë të mirë (në këtë botë duke qenë i respektuar e i kënaqur dhe furnizim e jetës sipas Ligjit të Allahut) dhe Ne do t’ua paguajmë padyshim atyre shpërblimin sipas veprave të tyre më të mira që ata i kanë punuar.” (En-Nahl, 97).

Kështu, meqë besimi i drejtë siguron prehje të zemrës dhe kënaqje me furnizimin e Allahut dhe e ruan zemrën që të mos lidhet me të tjerët përveç Allahut. Pikërisht kjo është jetë e mirë, ngase burim i i jetës së mirë është rehatia e zemrës dhe mosshqetësimi i saj nga gjërat nga të cilat shqetësohen zemrat të cilave iu mungon besimi i drejtë.

7. Të gjitha punët dhe fjalët e njeriut janë të vlefshme varësisht nga besimi dhe sinqeriteti që gjendet në njeriun përkatës. Për këtë arsye Allahu e përmend këtë kusht si themel të të gjitha veprave. Thotë Allahu në këtë kuptim:

“Në këtë mënyrë, kushdo që punon mirësi e drejtësi duke qenë besimtar (i Allahut në Islam), përpjekjet e tij nuk do të hidhen poshtë...” (El-Enbija, 94)

Allahu pra, nuk ua çvlerëson mundin atyre dhe nuk ua humb punën, përkundrazi ua shumëfishon atë, varësisht nga fuqia e besimit të tyre. Allahu thotë:

“Dhe kushdo që dëshiron jetën e fundit dhe përpiqet dhe i shërben asaj me mundimin që duhet për të (duke punuar në bindjen e Allahut) duke qenë besimtar (i Allahut

në Islam), **atëherë të tillët janë ata përpjekja e të cilëve do të jetë e e falënderuar dhe e shpërblyer nga Allahu.”** (El-Isra, 19)

Mundi për botën e ardhshme bëhet duke punuar çdo gjë që afron tek ajo. Ato punë janë ato që i ka ligjësuar Allahu përmes gjuhës së të dërguarit të Tij, Muhammedit, paqja e Allahut qoftë mbi të. Po qe se ato punë bazohen në besim dhe lulëzojnë nga ai, atëherë ky mund të falënderohet, të pranohet dhe shumëfishohet shpërblimi i tij dhe nuk humb nga ai asnjë fije e vogël. Kurse, nëse punës i mungon besimi, atëherë edhe nëse ditë e natë bën punë, ato nuk i pranohen. Këtë e dëshmon fjala e Allahut:

“Dhe Ne do t’i kthehemi çfarëdo lloj pune që bënë ata (mosbesimtarët) dhe do t’i bëjmë veprat e tilla si grimca pluhuri që fluturojnë në hava.” (El Furkan, 23)

Kështu, sepse ajo nuk bazohet në besimin në Zotin dhe në të Dërguarin e Tij. E para (besimi në Zotin) është boshti i sinqeritetit, ndërsa e dyta (besimin në të Dërguarin e Tij) kërkon që të pasohet udhëzimi i atij të Dërguari. Allahu thotë:

“Thuaju (o Muhammed): ‘A t’ju tregojmë në humbësit më të mëdhenj të veprave të tyre! Ata përpjekjet e të cilëve janë harxhuar kot në jetën e dynjasë duke menduar se po përfitonin mirësi nga veprat e tyre! Këta janë ata të cilët mohojnë ajetet (provat, shenjat, shpalljet) e Zotit të tyre dhe takimin me Të (në jetën e pastajme për të dhënë llogari), kështu që veprat e tyre janë të kota e nuk do t’u sjellin dobi dhe në Ditën e Kiametit Ne nuk do t’ua vëmë në peshojë fare.” (ElKehf, 103-105)

Ata, pra, kur e humbën besimin dhe vendin e tij e zuri mohimi (kufri) i ajeteve të Allahut, atëherë punët e tyre u bënë hi e pluhur.

Allahu thotë:

“Në qoftë se bashkoni të tjerë në adhurim me Allahun, sigurisht që gjithë punët tuaja do të jenë të pavlera.” (Ez-Zumer, 65)

Dhe thotë, gjithashtu: “Por sikur ata të kishin bashkuar të tjerë në adhurimin e Allahut (t’i kishin vënë shok Allahut në adhurim), gjithçka që ata kanë punuar do të kishte qenë pa asnjë vlerë për ta.” (El-En’am, 88)

Për këtë shkak, ai që e braktis besimin atij i zhvlerësohen të gjitha punët e mira, ashtu sikurse që hyrja në Islam dhe në besim i zhduk veprat e këqija të mëparshme, edhe nëse janë të mëdha. Sepse pendimi dhe kërkimi i faljes për mëkatet të cilat janë në kundërshtim me besimin dhe të cilat e dëmtojnë atë, i fshijnë të gjitha mëkatet që janë bërë më parë.

8. Atë që beson Allahu e udhëzon në Rrugën e drejtë. Atë Allahu e udhëzon në dijen e vërtetë, në punë të mira dhe që t’i përcjellë të mirat dhe gëzimet me falënderim, kurse fatkeqësitë dhe të këqijat me pajtim dhe durim. Allahu thotë:

“Pa dyshim se ata që besojnë (në njëjësinë e Allahut dhe në kushtet e tjera të besimit islam) dhe punojnë mirësi e drejtësi, Zoti i tyre do t’i udhëzojë nëpërmjet besimit të tyre.” (Junus, 9)

Dhe thotë:

“Asnjë fatkeqësi nuk bie, por veçse me lejen e Allahut dhe kushdo që beson Allahun, Ai e udhëzon zemrën e tij (drejt besimit të vërtetë).” (Et-Tegabun, 11)

Disa nga muslimanët e hershëm kanë thënë përkitazi me këtë njeri për të cilin flet ky ajet: “Ai është njeriu të cilin e godet fatkeqësia, e ai e di se është nga Zoti, prandaj pajtohet me të dhe kënaqet me këtë caktim.”⁴⁴

Është edhe një fryt i besimit, që sikur të mos kishte tjetër veç tij do të mjaftonte. E ai është se:

9. E bën njeriun t’i harrojë fatkeqësitë dhe të këqijat që i kanosen çdonjërit në çdo kohë. Besimi dhe bindja në Allahun është faktori kryesor që e bën njeriun t’i harrojë fatkeqësitë dhe që ia lehtëson ato atij, për shkak të fuqisë së besimit të tij, fuqisë së mbështetjes së tij në Allahun, fuqisë së shpresimit në shpërblimin e Zotit të tij dhe lakmisë së tij që e ka për të mirat e Tij. Ëmbëlsia e shpërblimit pakëson hidhësinë e durimit. Allahu ka thënë:

“Në qoftë se ju përjetoni vështirësi, atëherë sigurisht edhe ata po përjetojnë si edhe ju, por ju keni shpresë nga Allahu (për shpërblim, për Xhennet), gjë të cilën ata nuk e shpresojnë.” (En-Nisa, 104)

Për këtë, gjejmë dy veta të cilët i ka goditur një fatkeqësi e njejtë ose e përafërt me njëra-tjetrën. Njëri prej tyre beson, ndërsa tjetri nuk beson.

⁴⁴ Transmetim hasen. E shënon Taberiu (28/ 80) dhe është thënie e Alkame ibën Kajsit.

Është dallim i madh të vërehet se si e përjeton secili nga ata atë fatkeqësi dhe çka shkakton ajo tek secili nga ata. Shkaku i këtij dallimi është besimi dhe vepra që e përcjell atë besim.

Ashtu sikur që imani i ndihmon njeriut t'i harrojë fatkeqësitë, po ashtu ai ia lehtëson dhembjen njeriut në rast se ai humb ndonjë nga të dashurit e tij. Kur të humbë njeriu ndonjë nga të dashurit e tij për të cilin e ka të lidhur zemrën, për shembull prindin, fëmijën, pasurinë, mikun etj., ëmbëlsia e besimit i mundëson atij ta harrojë atë ose t'ia lehtësojë këtë dhembje, ngase besimi është zëvendësimi më i mirë i çdo të humburi, siç është e vërtetuar kjo praktikisht nga jeta e besimtarëve.

Bindja e fortë në Allahun qe ajo që ia lehtësoi dhembjen peygamberit të Zotit, Jakubit, për humbjen e djalit të tij, Jusufit, të cilin e donte shumë, kur djemtë e tij kërkuan nga ai ta lërë Jusufin të lozë me ta, e ai u tha:

“Në të vërtetë më brengos ajo që ju të ma largoni atë prej meje.” (Jusuf, 12)

U tha se nuk mund të lejojë të shkojë me ta, sepse nuk mund të ndahet as një orë nga ai. Por ata e arsyetuan idenë e tyre për ta lënë Jusufin të shkojë me ta dhe Jakubi ua lejoi

“...që Allahu ta mund të përmbushte një çështje të përcaktuar që më parë (në dijen e Tij).” (El Enfal, 42)

A mund të jetojë një njeri që ka dashuri të papërshtueshme për djalin e tij aq gjatë edhe pas humbjes së djalit?! Jo, assesi! Por, sigurisht se dashuria do t'ia copëtonte mëlçitë shumë shpejt. Mirëpo, fuqia e besimit dhe fuqia e shpresës

në Allahun i ka mundësuar atij të përmbahet gjatë gjithë asaj kohe, derisa Allahu erdhi me shtegdaljen të cilën ua premtoi besimtarëve.⁴⁵

Gjithashtu, edhe nëna e Musait, kur ajo vuante për Musanë e zemra e saj digjej nga malli për të... E sikur të mos frymëzonte Allahu në zemrën e saj besimin dhe që ajo pastaj të kuptonte se premtimi i Allahut është i sigurt, ajo do të kishtë shprehur atë që fshehte në vete dhe do të fliste për fatin e saj. Por besimi është ai që të forcon në vështirësi, kur të të zbehen forcat, që t'i lehtëson dhembjet e fatit të keq, e të bën të qëndrueshëm kur të grumbullohen telashet dhe sprovat.

Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, ka lënë një porosi të madhe. Ai thotë: “Njihe Allahun kur të jesh në gjendje rehatie, Ai do të të njeh kur je ngusht.”⁴⁶ Që do të thotë, nëse e njeh Allahun, d.m.th. beson Atë dhe i kryen detyrimet e besimit, sa je i pasur e i fortë, Allahu do të të njohë në vështirësi dhe telashe, d.m.th. do të të japë forcë që t'i përballosh ato vështirësi dhe do të të ndihmojë t'i mënjanojë ato.

Pasi që vështirësia më e madhe për besimtarin janë sprovat në agoni të vdekjes, ky hadith është përgëzim për secilin besimtar që e njeh Zotin në gjendje rehatie, se Allahu do ta ndihmojë atë kur t'i ketë punët pisk, kur të ketë probleme, kur forcat e tij të dobësohen dhe kur shejtanët t'i jenë grumbulluar e të kenë marrë hov për të mos lejuar që jetën e vet ta përfundojë me të mira.

⁴⁵ Lexo për tregimin e Jusufit në librin e po të këtij autori “Kasasul enbija”.

⁴⁶ Hadith sahih. E shënon Ahmedi (1/ 293, 303, 307), dhe Tirmidhiu (2615) i cili thotë se është sahih. Ky hadith është përcjellë përmes shumë rrugëve.

Në ato momente, Allahu me mëshirën e Tij do ta ndihmojë dhe do ta përkrahë atë, kur askush tjetër nuk ka forcë e mundësi t'i dalë në ndihmë në ato çaste, përveç Allahut.⁴⁷

Nga frytet e besimit dhe frytet e veprave që burojnë nga ai është ajo që thotë Allahu:

10. “Vërtet se ata që besojnë (në njëjësinë e Allahut, në të Dërguarin e Tij Muhammed) dhe që punojnë mirësi e drejtësi, i Gjithëmëshirshmi (Allah) do të fusë dashuri për ta (në zemrat e besimtarëve).” (Merjem, 96)

Pra, për shkak të besimit të tyre dhe punëve që burojnë nga ai besim, Allahu i do ata dhe në zemrat e besimtarëve fut dashurinë për ta. Ai të cilin e do Allahu dhe besimtarët e Tij, do të jetë i lumtur dhe i gëzuar dhe do të përfitojë shumë të mira nga dashuria e besimtarëve që e kanë për të. Ato të mira janë: përmendja dhe lavdërimi që ia bëjnë atij, lutja që e bëjnë për të sa është gjallë dhe vdekur, do ta marrin si shembull të mirë për ta pasuar dhe do të bëhet prijës fetar i tyre. Besimtarëve të cilët e plotësuan besimin e tyre me dije dhe punë, Allahu do t'ua bëjë gjuhën e tyre të flasë vetëm drejtë dhe do t'i bëjë ata prijës që udhëzojnë sipas urdhrat të Tij. Allahu thotë për ta:

⁴⁷ Thotë Hafidh Ibën Rexheb: “Kush i nënshtrohet Allahut dhe i respekton urdhrat dhe ndalesat e Tij në jetën e tij, Allahu do ta ndihmojë atë në agoninë e vdekjes, do t'a mundësojë të vdesë me besim, do ta bëjë të qëndrueshëm në varr kur do ta pyesin dy engjëjt do ta sigurojë nga dënimi në varr dhe nuk do ta lërë të vetmuar në varrin e errët dhe të egër... Ndërsa, ai që nuk e njuh Allahun kur është në gjendje rahatit dhe komforti, atë nuk e njuh askush kur ka halle dhe derte, as në këtë jetë, por as në të ardhmen. Gjendjen e tyre në këtë jetë kemi pasur mundësi ta shohim kudo, por halli i tyre në jetën e ardhme do të jetë edhe më keq, sepse atje Allahu nuk do tu ndihmojë.” (Nga “Nurul iktibas”, faqe 75-77)

“Dhe Ne bëmë nga mesi i tyre prijës duke udhëzuar nën urdhrin Tonë kur qenë të duruar dhe gjithnjë besuan me vendosmëri në ajetet Tona (provat, treguesit, shpalljet Tona).” (Es-Sexhdeh, 24)

Pra, me durim dhe bindje, me punë që llogariten të jenë kulmi dhe plotësimi i besimit ose imanit, ata e arritën pozitën e prijësit fetar.

11. Fjala e Allahut:

“Allahu i lartëson ata që besojnë dhe ata të cilëve u është dhënë dija në grada të larta.” (El-Muxhadeh, 11)⁴⁸

⁴⁸ Thotë dietari i madh, Ibnul Kajjimi, me rastin e interpretimit të këtij ajeti: «Në librin e Tij, Allahu tregon në katër vende se i ka ngritur disa kategori të njerëzve: I pari nga ato është ky ajet;

I dyti: **“Besimtarë janë vetëm ata të cilët kur përmendet Allahu ndiejnë frikë në zemrat e tyre dhe kur u lexohen vargjet e Tij (Kur’ani), ato ua shtojnë edhe më besimin: dhe ata i mbështeten vetëm Zotit të tyre; të cilët kryejnë me përpikëri namazin dhe që shpenzojnë me ato gjëra me të cilat Ne i kemi furnizuar. Mu këta janë besimtarët e vërtetë. Për këta do të ketë grada të larta te Zoti i tyre dhe falje dhe begati të nderuar.”** (El Enfalë, 2-4);

I treti: **“Por kushdo që shkon tek Ai (Allahu) si besimtar (i Tij) dhe ka bërë vepra të mira, mu për këta janë shkallët më të larta.”** (Ta ha, 75);

I katërti: **“...por, Allahu ka parapëlqyer ata që përpiqen dhe që luftojnë (muxhahidët) përmbi ata që rrinë në shtëpi me një shpërblim të madh. Shkallë të larta vlerësimi prej Tij si edhe falje dhe mëshirë....”** (En-Nisa, 95 dhe 96)

Në tri rastet e para nga këto katër raste, Allahu e ka ngritur kategorinë që karakterizohe me besim, që është dituria dhe punët e mira, ndërsa në rastin e katërt e ka ngritur kategorinë që kanë luftuar në Rrugë të Allahut, a kanë bërë xhihad në Rrugë të Tij. Vërehet se në të katër rastet shkaku i gradimit të atyre njerëzve nga ana e Allahut është dituria dhe xhihadi (lufta në Rrugë të Allahut), ngase me këto të dyja ruhet Feja.” (“Miftahu daris-seadeh, 1/ 224)

Besimtarët dhe dijetarët Allahu i ngre në dynja dhe në ahiret (botën e ardhme), prandaj ata janë njerëzit më të ngritur te Zoti i tyre ndër njerëz, në këtë botë dhe në të ardhmen. Këtë gradim ata e arritën me besimin e tyre të drejtë, me diturinë dhe me bindjen e tyre në Allahun, sepse dituria dhe bindja përbëjnë themelin e imanit (besimit).

12. Besimtari merr myzhden për nderimin që do t'ia bëjë Allahu dhe sigurinë e plotë nga të gjitha aspektet. Allahu thotë: “Jepu myzhde besimtarëve!...” pa e përkufizuar këtë me diçka të caktuar, në mënyrë që kjo myzhde të kaplojë të gjitha të mirat në këtë botë dhe në të ardhmen. Ndërsa në një vend tjetër thotë:

“Dhe jepu myzhde atyreve që besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi (sipas këtij besimi), se për ta do të ketë kopshte të begata (të Xhennetit) nën të cilët rrjedhin lumenj.” (El-Bekarah, 25)

Prandaj, për ta ka myzhde të pacaktuar dhe të caktuar. Kurse, në një ajet tjetër thuhet se ata janë të sigurtë:

“Janë tamam ata që besojnë (në njëjësine e Allahut dhe nuk adhurojnë tjetër përveç Atij) dhë nuk e ngatërrojnë besimin e tyre me padrejtësi (me të gabuarën, duke adhuruar tjetër përveç Allahut), për të cilët ka siguri të plotë. Mu këta janë të udhëzuarit.” (El-En’am, 82)

Ndërsa në një vend tjetër thotë se janë të sigurtë nga një gjë e caktuar:

“Kështu pra, për këdo që beson dhe punon drejtësi e mirësi, nuk do të ketë as frikë e as pikëllim.” (El-En’am, 48)

Allahu ata i siguroi nga frika dhe brenga për të ardhmen dhe nga pikëllimi për të kaluarën. Në këtë mënyrë ata janë plotësisht të sigurtë. Besimtarit i takon siguria e plotë në dynja dhe në ahiret, ai është i sigurt nga zemërimi dhe dënimi i Allahut dhe nga të gjitha të këqijat e tjera. Atyre u jepet myzhde për çdo të mirë nga ana e Allahut:

“Për të ka myzhde në jetën e kësaj bote (ëndërr e drejtë e parë nga dikush ose e shfaqur të tjerëve) dhe në jetën e ardhshme.” (Junus, 64)

Këtë myzhde e përcakton fjala e Allahut:

“Vërtet se atyre që thonë: - Zoti ynë është Allahu dhe pastaj qëndrojnë të paluhatur në këtë, tek ata do të ulen melekët (duke u thënë në kohën e marrjes së shpirtit): Mos kini frikë, as mos u pikëlloni! Por, merrni myzhden e përgëzimit me xhennet i cili ju qe premtuar! Ne kemi qenë miqtë tuaj në këtë botë dhe jemi të tillë edhe në jetën e fundit. Atje ju do të keni gjithçka që do t’ju dëshirojë shpirti dhe për ju atje do të ketë çfarë të kërkonit. Kënaqësi nga (Allahu), gjithnjë Falës i Madh, Mëshirëplotë.” (Fussilet, 30-32)

Allahu thotë:

“O ju që keni besuar (Musanë, o ju çifutë; dhe Isanë, birin e Merjemes, o ju kristianë)! Kini frikë Allahun dhe besoni edhe të Dërguarin e Tij (Muhammedin). Ai do t’ju japë dy herë shpërblim nga mëshira e Tij, dhe Ai do t’ju japë juve dritë me të cilën do të ecni (në Udhën e drejtë), dhe Ai do t’ju falë ju. Dhe Allahu është gjithnjë falës i Madh, Mëshirëplotë.” (El Hadid, 28)

Pra, për shkak të besimit, Allahu i shpërblen ata me shpërblim të shumëfishuar dhe u jep atyre dritë të plotë, me të cilën ecin në këtë botë dhe do të ecin me të në botën e ardhme.

“Ditën kur do të shihni besimtarët dhe besimtare, se si prin ndriçimi përpara tyre dhe nga e djathta e tyre. Myzhe për ju këtë Ditë! Kopshte të begata nën të cilat rrjedhin lumenj për të banuar ndër to (në Xhennet) përgjithmonë! Ky është tamam ai ngadhënjimi madhështor!” (El Hadid, 12)

Besimtari ecën me dritën e dijes dhe besimit të tij në dynja dhe në ahiret, e kur të fiken dritat Ditën e Kiametit, ai ecën me dritën e tij derisa ajo ta shpjerë në Vendbanimin e nderit dhe të dhuntive (në Xhennet).

13. Besimi tërheq faljen e mëkateve, e atij që i falen mëkatet shpëton nga dënimi dhe arrin shpërblimin më të madh.

14. Arritja e shpëtimit.

Ky është qëllimi më i lartë që mund të synojë njeriu dhe shpëtim nga çdo frikë.

Pasi Allahu përmendi qëndrimin e besimtarëve përkitazi me atë që Zoti ia zbriti Muhammedit dhe pejgamberëve më parë, lidhur me të fshehurën (gajbin), si dhe me faljen e namazit, dhënien e zekatit, që konsiderohen si gjurmët më të mëdha të besimit, tha:

“Ata udhëhiqen në Rrugë të vërtetë nga Zoti i tyre dhe ata janë më të suksesshmit.” (El Bekarah, 5)

Ky është udhëzimi dhe shpëtimi i plotë. Nuk ka rrugë për të arritur udhëzimin dhe shpëtimin e plotë, pa të cilat nuk ka mirëqenie dhe lumturi, veçse duke besuar të gjithë librat e shpallur nga Allahu dhe të gjithë të dërguarit e Tij. Ky udhëzim, pra është mënyra më e mirë dhe ky shpëtim është qëllimi më i lartë.

15. Përfitimi nga këshillat, përkujtimet dhe ajetet e Zotit Allahu i madhërishëm ka thënë:

“Dhe kujto (fto me Kur’anin, o Muhammed) pasi përkujtimi i ngre dhe u sjell dobi besimtarëve.” (Edh-Dharijat, 55),

“Me të vërtetë që atje është një shenjë treguese e madhe për besimtarët.” (El-Hixhr, 77).

Kështu, sepse besimi e çon poseduesin e tij t’i përmbahet dhe ta pasojë të vërtetën, me fjalë e me vepra, dhe me vete ka edhe mjetin e madh: gatishmërinë për të pranuar këshillat e dobishme dhe faktet që dëshmojnë të vërtetën. Kështu, atë nuk e pengon asgjë që të pranojë të vërtetën dhe të punojë sipas saj. Veç kësaj, besimi e ruan pastërtinë e natyrshmërisë (fitrah) i njeriut, qëllimin e mirë, e njeriu që i ka këto dy veti përfiton nga ajetet e Allahut, ndërsa ai që nuk i ka këto dy cilësi, atëherë nuk është çudi kur i tilli nuk e pranon të vërtetën dhe nuk e pason atë. Allahu na lajmëron se shkakun pse jobesimtarët e mohojnë të Dërguarin e Zotit dhe nuk e pranojnë të vërtetën me të cilën ka ardhur ai, është mosbesimi i qëllimtë i tyre (kufri). Sepse e vërteta është e qartë dhe provat e saj janë të qarta dhe të shpjeguara, por mosbesimi (kufri) është pengesa me e madhe që ndalon nga

pasimi i tij. Dhe mos u çuditni me këtë dukuri, ngase ky është adet i çdo jobesimtari.

16. Imani e bën pronarin e tij të falënderojë kur është në gjendje të mirë, dhe të durojë kur është në gjendje të keqe, që në këtë mënyrë të fitojë të mirën në çdo rast dhe në çdo gjendje.

Është vërtetuar se Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “E çuditshme është gjendja e besimtarit! Gjendja e tij në çdo rast është e dobishme për të. Nëse është në gjendje të mirë, ai falënderon, dhe kështu e mira i kthehet atij. E nëse është në gjendje të keqe bën durim, dhe kështu i bën dobi vetes. Kjo punë është kështu vetëm për besimtarin.”⁴⁹ Falënderimi dhe durimi përmbledhin gjithë të mirat. Në këtë mënyrë besimtari di t’i shrytëzojë të mirat në çdo kohë dhe përfiton në çdo gjendje që të jetë.

Në koleksionet e haditheve të vërteta shënohet se Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Për çdo brengë, mërzi dhe shqetësim me të cilat sprovohet besimtari, Allahu ia mbulon atij disa nga mëkatete tij.”⁵⁰ Kështu, besimtarit kur është në gjendje të mirë, i grumbullohen dy të mira: dobia që ka nga vetë ajo e mirë dhe dobia e falënderimit, e cila është edhe më e dobishme se e para. Në këtë mënyrë, dobia e tij është më e plotë. Ndërsa, kur besimtari është në gjendje të keqe, atij i grumbullohen tri të mira. E para nga ato është se atij i falen mëkatet; e dyta: e arrin gradën e durimit, e cila është më me rëndësi se e para, dhe e treta është se i lehtësohet ajo e keqe, ngase kur është i

⁴⁹ E shënon Muslimi(2999 dhe 64) nga Suhejb ibën Sinan.

⁵⁰ E shënon Buhariu (5641 dhe 5642) dhe Muslimi (2573 dhe 52) nga Ebu Seid el Hudarij dhe nga Ebu Hurejra.

vetëdijshëm se për atë të keqe do të ketë shpërblim dhe di ta përballojë atë të keqe me durim, ai e përjeton më lehtë atë sprovë dhe barra e saj i vjen më e lehtë.

17. Besimi i ndërpret dyshimet.

Dyshimet i paraqiten shumë njerëzve dhe e dëmtojnë fenë e tyre. Allahu ka thënë: “Sigurisht që besimtarët janë vetëm ata që kanë besuar Allahun dhe të të Dërguarin e Tij dhe pastaj nuk kanë më pikë dyshimi...” (El-Huxhurat, 15)

D.m.th., besimi i tyre i drejtë i largon dyshimet, i zhduk ato krejtësisht dhe u bën ballë dyshimeve që i fusin shejtanët nge njerëzit, xhindet dhe shpirti që nxit në punë të liga. Nuk ka ilaç tjetër për këto sëmundje shkatërruese përveç jetësisht të besimit. Në këtë kuptim Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Njerëzit vazhdimisht do të pyesin njëri-tjetrin (për krijesat, krijuesin dhe krijimin) derisa të thuhet: Allahu është Ai i cili i krijoi krijesat, po kush e krijoi Allahun? Atë të cilin e bren ky dyshim le të thotë: besoj në All-llahun, le të ndërpresë mendimin për këtë dhe le të kërkojë mbrojtje nga Allahu prej shejtanit.”⁵¹ Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, e ka treguar ilaçin shërues për këtë sëmundje shkatërruese. Ai ilaç përbëhet nga tri gjëra:

E para: ndalimi nga mendimi rreth këtyre cytjeve djallëzore;

E dyta: kërkimi i mbrojtjes nga Allahu prej cytjes së shejtanit me të cilën ai fut dyshime që t’i shmangë njerëzit nga Rruga e drejtë,

⁵¹ E shënon Buhariu (3276) dhe Muslimi (134 dhe 112) me këtë kuptim dhe përafërsisht me këtë shprehje.

E treta: strehimi nën strehën e besimit të drejtë, në të cilën është i sigurt kushdo që futet nën të.

E pavërteta është e njohur e qartë nga shumë aspekte. Së pari, sepse ajo është në kundërshtim me të vërtetën, e çdo gjë që është në kundërshtim me të vërtetën është e pavërtetë.

“Kështu pas së vërtetës, ç’gjë tjetër mund të ketë përveçse së gabuarës?” (Junus, 23)

18. Imani është vendstrehimi i besimtarëve në gjendje gëzimi, pikëllimi, frike, sigurie, kur të jetë i nënshtruar ndaj Allahut, kur të mëkatojë dhe në gjendje të tjera që jeta i sjell atij.

Në gëzime dhe kënaqësi ata e falënderojnë dhe e lavdërojnë Allahun, ndërsa dhuntitë e Tij i shfrytëzojnë në ato punë që Allahu i do dhe i pëlqen.

Në fatkeqësi dhe pikëllime, ata strehohen te besimi nga disa aspekte: me ndihmën e besimit të tyre dhe ëmbëlsisë së tij, ata i harrojnë ato fatkeqësi dhe pikëllime; me shpresën që e kanë në shpërblimin e Allahut për shkak të fatkeqësisë përkatëse, ata e harrojnë atë fatkeqësi dhe atë pikëllim; pikëllimet dhe brengat i përjetojnë zemërqetë dhe shikojnë në pjesën e mirë të jetës, që kështu t’i përballojnë pikëllimet dhe vuajtjet.

Në raste frike strehohen te besimi dhe aty ndihen të qetë. Kjo edhe më ua shton imanin dhe ua forcon qëndrimin, ua shton fuqinë dhe trimërinë dhe në këtë mënyrë frika që i shqetëson venitet derisa të zhduket krejtësisht. Allahu ka thënë përkitazi me krijesat e tij të zgjedhura:

“Ata (besimtarë) të cilëve njerëzit (hipokritët) u thanë: Vërtet populli (pagan) ka grumbulluar kundër jush (një ushtri të madhe), kështu që frikësojuni atyre! Por kjo në të vërtetë vetëm u shtoi besimin dhe thanë: Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Mbrojtësi më i mirë. Kështu që ata u kthyen në mirësi dhe begati nga Allahu.” (Ali Imran, 173-174)

Nga zemra e këtyre krijesave të zgjedhura u zhduk frika, e vendin e saj e zuri fuqia e besimit dhe ëmbëlsia e tij, fuqia e mbështetjes në Allahun dhe bindja në premtimin e Tij.

Në gjendje sigurie ata strehohen te besimi dhe nuk bëhen arrogantë, jofalënderues dhe mendjemëdhenj, por janë modestë dhe e dinë se kjo e mirë është nga Allahu, nga dhuntitë dhe lehtësimet e Tij. Prandaj e falënderojnë Atë, tek i cili kthehet krejt shkaku i së mirës. Dhe e dinë se po qe se triumfojnë mbi armikun, ajo bëhet me ndihmën, fuqinë dhe mirësinë e Allahut, e jo me mundësitë dhe fuqinë e tyre.

Kur tregohen të devotshëm dhe të nënshtrueshëm ndaj Allahut dhe kur adhurimi i Tij dhe punët e mira bëhen të lehta dhe të këndshme për ta, atëherë ata i pohojnë këto dhunti të Allahut që ua ka dhënë atyre, të cilat për ta janë më të mira se shëndeti dhe furnizimi material.

Gjithashu, ata kujdesen që këto të mira (devotshmërinë, nënshtrimin, adhurimin, punët e mira) t’i shtojnë dhe plotësojnë edhe më duke përcjellë shkaqet që çojnë nga ato dhe kujdesen që të mos lënë mangësi në to. E lusin Allahun, i Cili ua bëri të mundshme të jenë të nënshtruar ndaj Tij, që t’ua plotësojë ato të mira dhe t’ua plotësojë mangësitë që kanë lënë në to.

Në rast se sprovohen me mëkate, ata gjejnë strehim te besimi dhe shpejtojnë të pendohen e të bëjnë vepra të mira që t'ua fshijnë gjynahet. Allahu thotë për ta:

“Në të vërtetë ata që janë të përkushtuar kur u vjen ndonjë mendim i lig prej shejtanit, ata kujtojnë (Allahun) dhe vërtet që pas kësaj ata shohin (drejt).” (El-A'raf,201)

Ndërsa, Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, thotë: “Besimtari (në raport me besimin) është sikur kali i lidhur për hurin e tij, brendh sa të bredhë e më në fund kthehet në hurin e tij.”⁵² Kështu, besimtari brendh në pakujdesi dhe bie në disa mëkate, pastaj me nxitim kthehet në besimin mbi të cilin e ka ngritur gjithë jetën dhe sjelljen e tij.

Vendstrehimi i besimtarëve, në të gjitha situatat që gjendet, është besimi, zbatimi dhe pasqyrimi i këtij besimi në jetë dhe refuzimi i çdo gjëje që e mohon dhe e kundërshton atë.

19. Besimi i drejtë e ruan njeriun që të mos bjerë në mëkatet shkatërruese.

Është vërtetuar se Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Zinaqari⁵³ në momenti kur bën zina nuk është besimtar. Vjedhësi në momentin kur vjedh nuk është besimtar.

⁵² Hadith daif (i dobët). E shënon Ahmedi (3/ 37, 55) dhe Ibën Hibbani (616) me zinxhir transmetuesish daif (të dobët). Në të haset Ebu Sulejman el-Lejthijj, për të cilin thotë Alijj ibën Medinijj se është mexhul (i panjohur). Kuptimi i hadithit: Mëkatet besimtarin e largojnë nga Zoti i tij, ndërsa esenca e imanit të tij akoma gjendet në të. (En-Nihajetu fi garibil ether, (1/29, 30) Ibën Ethir.)

⁵³ Është përdorur si emërtim për njeriun i cili bënë zina, d.m.th. që kryen akt seksual me partnerin joligjor të tij.

Pirësi i alkoolit në momentin kur pi alkool nuk është besimtar...⁵⁴ Kushdo që bie në këto gjynahe, bie për për shkak të dobësisë së besimit të tij, fikjes së dritës së besimit dhe heqjes së turpiti nga Ai që e sheh dhe që e ka ndaluar nga ajo punë. Ndërsa, besimi i drejtë dhe i sinqertë lind turpin nga Allahu, dashurinë për Të, shpresimin në shpërblimin e Tij, drojën nga dënimi i Tij dhe dritën që e ndrit errësirën. Nuk ka dyshim se këto gjëra, të cilat e plotësojnë besimin, e shtyejnë njeriun në çdo të mirë dhe e pengojnë atë nga çdo punë e shëmtuar. Prandaj, Pejgamberi, ka thënë se nëse gjendet te besimtari vullneti për të bërë këto mëkate, atëherë drita që sjell bësimi i tij, ëmbëlsia e atij besimi dhe turpi nga Allahu (që është nga degët më të mëdha të besimit), e ruajnë atë që të mos bjerë në këto punë të liga.

20. Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Besimtari i cili lexon Kur’an është sikur qitroja⁵⁵, shija e së cilës është e mirë dhe era e këndshme. Ndërsa besimtari që nuk lexon Kur’an është sikurse hurma, shija e së cilës është e mirë, por erë nuk ka.”⁵⁶

Këto dy kategori janë njerëzit më të mirë, meqë njerëzit janë katër llojesh:

Lloji i parë: I mirë për veten dhe për të tjerët. Kjo është kategoria më e mirë. Fjala është për besimtarin që lexon Kur’anin dhe i mëson shkencat e Fesë.

⁵⁴ E shënon Buhariu (3810) dhe Muslimi (57, 104). Përcillet nga Ebu Hurejra.

⁵⁵ Qitro: Fryt me kokra të mëdha me ngjyrë të verdhë e me lëkurë të trashë, me pak lëng, e me shije si të athët, që përdoret për ëmbëlsira dhe për të nxjerrë një esencë me erë të mirë.

⁵⁶ E shënon Buhariu (5427) dhe Muslimi (797, 234).

Ai është i dobishëm për veten etij dhe për të tjerët, i bekuar kudo që të jetë. Siç tregon Allahu se Isai, paqja e Allahut qoftë, mbi të ka thënë:

“Dhe Ai më ka bërë mua të bekuar kudo që të jem...”

(Merjem, 31)

Lloji i dytë: I mirë vetëm për vetveten. Ai është besimtari që nuk ka dituri me të cilën mund t’u bëjë dobi të tjerëve.

Këto dy kategori të lartëpërmendura janë krijesat më të mira.

Lloji i tretë: Nuk ka hajr nga ai, por as që nuk u sjell dëm të tjerëve.

Lloji i katërt: Që i bën dëm vetes dhe të tjerëve. Kjo është kategoria më e keqe. Ata janë për të cilët flet Allahu në Kur’an:

“Ata që nuk besuan dhe ndaluan njerëzit nga Udhja e Allahut, mu për këtë Ne do të shtojmë dënim mbi dënim, sepse ata përhapën djallëzi e poshtërsi (duke mohuar vetë dhe duke ndaluar edhe të tjerët nga Rruga e Allahut).” (En-Nahl, 88)

Pra, krejt shkaku që njeriun e bën të mirë qëndron në besimin e tij dhe në ato punë që i bashkohen atij besimi (d.m.th. veprat sipas atij besimi). Kurse shkaku që njeriun e bën të keq qëndron në mungesën e besimit.

Allahu është Ai që na ndihmon dhe përkrah.

Përafërsisht, në këtë kuptim është edhe thënia tjetër e Pejgamberit, paqja e Allahut qoftë mbi të: “Besimtari i fortë është i mirë dhe më i dashur tek Allahu sesa besimtari i dobët, edhe pse në të dytë gjendet hajr.”⁵⁷

⁵⁷ E shënon Muslimi (2664, 34) dhe e përcjell Ebu Hurejra.

Këtu Pejgamberi i ka kategorizuar besimtarët në dy kategori: të fortë në punë; besim dhe në sjelljen e dobisë të tjerëve, dhe kategoria e dytë: të dobëtit në këto tipare. Sidoqoftë, që të dy kategori janë të mira dhe të dobishme, sepse besimi dhe pasqyrimi i tij në praktikë çdoherë janë hajr, edhe pse besimtarët janë në grada të ndryshme sa i përket sasisë së këtij hajri.

Edhe një hadith tjetër është po në këtë kuptim: *“Besimtari i cili përzihet me njerëz dhe i duron bezdisjet e tyre është më i mirë se besimtari i cili nuk përzihet me njerëz dhe nuk i duron bezdisjet e tyre.”*⁵⁸

Ajka e kuptimit të këtyre teksteve është se nuk ka dobi nga njeriu të cilit i mungon besimi, sepse i tilli ose është i dëmshëm për shoqërinë e tij nga të gjitha aspektet, ose është

⁵⁸ Hadith sahih (i vërtetë). E shënon Ahmedi (2/43 dhe 5/365), Tirmidhiu (2507) dhe Ibën Maxhe (4032) me zinxhir transmetuesish sahih dhe e përcjell Ibën Umer. Shih “As-Sahih” të Albanit.

Dijetari i madh El Menavijj ka thënë në librin e tij Fejdul Kadir: “Nga shkallët më të larta të durimit është durimi gjatë përzierjes me njerëz dhe durimi i bezdisjeve të tyre. Dije se Allahu nuk t’i ka hipur mbi qafe ata njerëz për tjetër gjë përveçse për ndonjë mëkatim tëndin, prandaj kërko falje nga Allahu për atë mëkat dhe dije se kjo është dënim nga Allahu i Lartëmadhërisëm. Pra, rri me ta, dëgjo e përfito nga të mirat e tyre e bëhu i shurdhët ndaj të këqijave të tyre! Përmendi bamirësitë e tyre dhe hesht ndaj bezdisjeve të tyre...! Këtë e thotë Gazaliu.,,

Thotë Ebu Sulejman El Hattabijj: “Qëndrimi më i matur në këtë drejtim është që të mos ngurrosh të kryesh detyrat tuaja ndaj njerëzve, edhe nëse ata nuk e kërkojnë atë nga ti. Mos u merr bashkë me ta me të pavërteta, me mëkate e punë të kota me të cilat nuk je i deyrar, edhe nëse ata të thërrasin në këtë, sepse ai që shkrihet në të pavërteta, në mëkate e në punë të kota, bëhet i ngurtë ndaj së vërtetës.

Pra, ji me njerëz përderisa ata janë në hajr, e largohu prej tyre kur ata janë në sherr...!” (El azleh, fq. 98)

i dobishëm pjesërisht, nga disa aspekte, por dëmi i tij është më i madh se dobia, ngase ky dëm ka dominuar mbi atë dobi. Të mirat kur të zhyten dhe të shkrihen në të këqija bëhen të këqija, ngase karshi së mirës që gjendet tek ai qëndron një e keqe dhe kështu bien që të dyja (e mira dhe e keqja) dhe mbetet e keqja për të cilën nuk ka të mirë që të qëndrojë karshi saj.

Ai që përsiat rreth gjendjes së njerëzve, do ta shohë atë mu ashtu siç e ka përshkruar Pejgamberi, paqja e Allahut qoftë mbi të.

PËRFUNDIM

U bë e qartë nga ajo që u tha deri më tani se kjo pemë e bereqetshme, pema e besimit, është pema më e bekuar, më e dobishme dhe më e përhershme;

Se rrënjët dhe trugu i saj janë njohuritë dhe shkencat e besimit;

Se ujitja dhe degët e saj janë Ligji islam, punët e mira, morali i mirë, që shkojnë bashkë dhe ndihmohen me sinqeritetin ndaj Allahut dhe me ndjekjen e udhëzimit të të Dërguarit të Tij;

Se frytet e saj të pandërprera janë ndjekja e rrugës së drejtë, udhëzimi i mirë, morali i mirë, përmendja e Allahut, falënderimi dhe lavdërimi i Tij, sjellja dobi robërve të Allahut, aq sa mund të bëjë secili njeri, me dije, këshillë, pozitë, trup, pasuri dhe me gjëra të tjera që i ka në dispozicion;

Se kjo pemë në zemrat e besimtarëve ndryshon varësisht nga realizimi i tipareve që u përmendën;

Se fati dhe vendi i njeriut në botën e ardhshme dhe të amshueshme krejtësisht varet nga ky besim dhe nga pasqyrimi i këtij besimi në këtë jetë, dhe

Se të gjitha meritat për këtë i ka vetëm Allahu.

“Përkundrazi Allahu ka dhuruar një mirësi mbi ju, që Ai ju ka udhëzuar ju tek imani (besimi), sigurisht në qoftë se jeni të vërtetë e të çiltër (për atë që thoni).” (El-Huxhuratë, 17)

Banorët e xhennetit do të jenë mirënjohës ndaj Zotit të tyre për këtë dhunti të madhe të Tij, pasi që të kenë hyrë në të dhe të jenë përgatitur vendbanimet e tyre:

“Ndërsa ata thonë: “Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, i Cili na udhëzoi ne për këtë vend. Kurrë nuk do të kishim gjetur ne drejtim, po të mos na kishte udhëhequr Allahu. Vërtet që të Dërguarit e Zotit tonë erdhën në të Vërtetën. Që andej do të bëhet thirrja: Ky është Xhenneti të cilin ju e keni trashëguar për çfarë keni punuar.” (El-A’rafë, 43)

Në këtë ajet Allahu na lajmëron edhe për mirënjohjen dhe falënderimin që ia bëjnë banorët e xhennetit Atij për shkak të dhuntive dhe shpërblimit të Tij që i ka sjellë aty. Këtu Allahu e ka cekur edhe shkakun që i ka sjellë aty me ndihmën e Allahut, e që është puna e mirë që buron nga besmi.

Kërkojmë nga Allahu i Madhërishëm që të na furnizojë me besim të vërtetë, të mos na lejojë të mbështetemi në veten dhe fuqinë tonë as sa një e rrahur e qepallës, që të mos na i lajthitë zemrat pasi që na udhëzoi dhe të na mëshirojë. Ai është Dhuruesi më i madh. Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi Muhammedin, mbi familjen dhe shokët e tij besimtarë!

Përmbajtja

Parathënia e autorit 5

KAPITULLI I PARË

Përkufizimi i imanit (besimit) dhe kuptimi i tij 7

Imani shtohet dhe pakësohet 32

KAPITULLI I DYTË

Gjërat në të cilat bazohet imani (besimi) 37

KAPITULLI I TRETË

Dobitë dhe frytet e imanit (besimit) 59

Përfundim 85

هذا الكتاب منشور في

